



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 30 tetor 2020, në mbledhjen e XXXVII (tridhjetë e shtatë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Qëndrim Softolli, znj.Arlinda Kadriu, z.Fitim Muçolli, z.Blerim Maçastena dhe znj.Donjeta Jakupi të cilët munguan, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës dhe në të njëjtën kohë në cilësinë e ushtruesit të detyrave dhe kompetencave të Kryetarit të Komunës (*shkresa e MAPL-së me nr.prot.02-128/2 e datës 06.02.2020*) Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Konstatoi kuorumin dhe i njoftoj për mungesat e këshilltarëve për të cilët tha se më kanë njoftuar se nuk mund të marrin pjesë në këtë mbledhje. Shtoi konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë, andaj urdhëroni nëse keni diçka rreth rendit të ditës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe pse në mbledhjen e KPF-së unë në emër të këshilltarëve të LDK-së e kam përkrahur rendin e propozuar të ditës duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre pikave, mirëpo kur e kemi marrë thirrjen dhe materialin e kësaj seance, në fund është thënë se *materialin e Hartës Zonale në CD mund ta marrim në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit brenda orarit të rregullt të punës*. T'ju them të drejtën, unë dhe shumë koleg tjerë nuk e kanë vërejtur këtë njoftim e që edhe nuk e kanë marrë CD-në, por që ndërkohë unë dje e kam marrë, prandaj duke qenë në dijeni për rëndësinë e Hartës Zonale ndoshta do të ishte mirë që kjo pikë e rendit të propozuar të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës. Po ashtu për sot kemi shumë pika në kuadër të rendit të ditës, edhe pse për Hartën Zonale sipas procedurave ligjore është marrë vendimi për dhënien e pëlqimit për miratimin e këtij dokumenti për periudhën kohore 2020-2028 nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Gjithashtu ndër kohë mund të sqarohen edhe disa reagime të qytetarëve, andaj unë propozoj që pika e 2-të e rendit të ditës, propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën kohore 2020-2028, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

z.Bajram Ajeti, theksoi, edhe unë e pata në plan të marrë fjalën për këtë çështje dhe i bashkëngjitëm kërkesës së parafolësit për shtyrje të kësaj pike, duke marrë parasysh arsyet teknike që nuk ka arritur t'i furnizoj me kohë shërbimi administrativo teknik të gjithë këshilltarët e Kuvendit me materialin e nevojshëm, material i cili është shumë i rëndësishëm dhe që ka të bëjë me një periudhë të gjatë 2020-2028 për zhvillimin e Komunës qoftë në aspektin urbanistik qoftë ekonomik dhe gjitha fushat e jetës së qytetarëve, si dhe pamundësia që ky dokument të analizohet mirë.

Po ashtu një fakt tjetër që e shohë është se ju ka rrok "tërmeti" dhe nuk e kemi prezent drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e që është çështje e juaja përse nuk e kemi, mandej nuk e kemi asnjë specialist i cili do të ishte në gjendje të na jap neve përgjigje në çështjet për të cilat jemi të interesuar për shumë fusha të Hartës Zonale.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky projekt për të ardhmen e Komunës tonë, unë mendoj se do të ishte shumë më e arsyeshme shtyrja dhe asgjë nuk pengon përveç nëse iu keni premtuar klientëve tuaj që sa më shpejt t'i garantoni se do t'ju lejoni parcelat për ndërtimin e pallateve të tyre, përndryshe nëse jemi të arsyeshëm, korrekt dhe të sinqertë kjo çështje nuk ka nevojë të ngutet duke shpresuar që në mbledhjen e radhës do të jemi secili prej nesh më të përgatitur që vërtetë kur të miratohet Harta Zonale të jetë një dokument që do të mbrojë interesin e qytetarëve, hapësirës, ambientit, zhvillimit e të tjera, prandaj kërkoj që të shtyhet sepse nuk diçka për nguti edhe pse e kemi pëlqimin nga Ministria sepse fundja ai pëlqim nuk obligojnë por vetëm thuhet që kurdo që merret vendimi kemi për obligim që brenda 7 ditëve ta njoftojmë atë Ministri, asgjë tjetër nuk kemi obligim. Pra ky propozimi/ kërkesa në fjalë të hedhet në votim dhe kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, t'ju them të drejtën nuk e pata ndërmend të marrë fjalën por më bëri përshtypje fakti që dje në KPF kemi kërkuar me rekomandim që pika në fjalë e rendit të ditës të shtyhet, kurse Grupi i LDK-ës ka qenë kategorike që të rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, madje edhe votat kanë qenë 4 për, 4 kundër por që me votën e dyfishtë të Kryesuesit është vendosur që kjo pikë të rekomandohet për këtë mbledhje.

Faktikisht viti 2020 po kalon pa elementin kryesor që është Harta Zonale të cilën e kemi kërkuar të gjithë e që në një formë kjo e tregon më së mirë dembellëkun e Ekzekutivit të Komunës që të mos jetë në gjendje ta kemi Hartën Zonale në vitin 2020 e që mund të ndodh që edhe në vitin 2021 nuk do ta kemi. Me gjithë respektin për parafolësin z.Mehmet Gashi por arsyeja që e paraqiti ai në emër të Grupit të LDK-ës që Harta Zonale të shtyhet për seancën e radhës për arsye të CD-ve nuk qëndron sepse CD-të i kanë marrë Grupet e këshilltarëve të Kuvendit, madje ne opozitë jemi edhe i kemi marrë me kohë dhe i disponojmë ato, mirëpo këtu janë dy probleme sepse LDK propozon të shtyhet sepse nuk i ka numrat e mjaftueshëm për ta votuar Hartën Zonale sepse dje në KPF deponimi i tyre ka qenë që të votohet kështu siç është, si problem kryesor edhe pse disponimi ynë ka qenë që të shtyhet sepse kemi vërejtur që nuk është në rregull dhe kemi ankesa të qytetarëve që u janë drejtuar edhe Drejtorisë përkatëse dhe këtij Kuvendi, ndërsa problemi tjetër është se nuk është drejtori i Drejtorisë përkatëse i cili do ta elaboronte këtë dokument edhe pse në mungesë të tij është Nënkryetari i Komunës i cili është edhe Ushtrues i Detyrës së Kryetarit të Komunës dhe i cili mund ta arsyetoj këtë dokument sepse para rreth 7 ditësh ky dokument është sjellë me nënshkrim të vetë Nënkryetarit i cili në mungesë të drejtorit të Drejtorisë përkatëse është mirë ta paraqesë këtë dokument. Ne si opozitë jemi të njoftuar që as kryetarët e komiteteve, sidomos ata të qytetit nuk janë ftuar nëpër debate publike, persona të cilët vetë LDK i ka caktuar, pastaj nuk posedojmë procesverbale të atyre debateve që janë mbajtur lidhur me pjesëmarrjen dhe si është vendosur në Hartën Zonale për pjesë të caktuara të qytetit, çështje këto të cilat nuk mund t'i prezantoj askush këtu nga Ekzekutivi i Komunës, pra kjo është arsyeja sepse ka pasë ankesa edhe dje por edhe sot nga një

grup i qytetarëve e të cilat ky institucion duhet t'i shqyrtoj dhe të kthehen përgjigjet zyrtare, jo ne si opozitë. Elementi tjetër është se mungojnë numrat, prandaj mendoj se duhet të kemi koordinim për çështje madhore nëse veç të gjithë thirremi për interes të qytetarëve dhe të Komunës, por askush askënd nuk e ka kontaktuar se si do të veprojmë me Hartën Zonale, kështu që ne dje në KPF kemi propozuar që kjo pikë të shtyhet, jo për mungesë të CD-ve por nëse Kryesuesi i Kuvendit i ka mbajtur CD-të për Grupin e subjektit të tij dhe nuk ju ka shpërndarë atyre është mirë t'jua shpërndan tani, mirëpo konsideroj se CD-të në fjalë Grupi i këshilltarëve të LDK-ës i ka pasë para neve dhe për këtë jam shumë i sigurt, prandaj e them se arsyetimi nuk është i arsyeshëm.

Pra Harta Zonale shtyhet, asnjë arsye nuk qëndron për moskryerjen e punës nga komisioni përgjegjës i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por për mos aftësi dhe për mos dinamikë të punëve. Madje jam shumë i sigurt që po të ishin 18 numra (vota) nga Grupi i LDK-së këtë dokument të Hartës Zonale qysh sot do ta kalonin, mirëpo meqë mungojnë numrat edhe shtyhet kjo pikë, e them këtë sepse ne si opozitë dje në KPF kemi qenë kategorik për ta shtyrë kurse LDK ka qenë kategorike për ta kaluar, kurse sot arsyeja për mungesë të CD-ve nuk paraqet aspak problem, madje madje ne sot këtu mund të zgjatim këtë pikë dhe ta analizojmë në monitor ku mund të shihni se çfarë përshihet në Hartën Zonale, e që për mendimin tim parashikimet janë penguese për zhvillim për qytetarët e Komunës së Podujevës, përndryshe po të ishte pozitiv sa i përket zhvillimit nuk do të thotë se nuk do ta mbështetnim edhe ne, veçse jemi në opozitë. Prandaj nëse mund ta arsyetoj Nënkryetari i Komunës dhe kandidati për Kryetar, ta merre fjalën dhe ta arsyetoj dhe pastaj shikojmë, mirëpo ne edhe dje në KPF por edhe sot po kërkojmë të shtyhet kjo pikë, të shqyrtohen të gjitha ankesat e qytetarëve, madje madje meqë po shtyhet për probleme të shfaqura ne si Grup nga radhët e PDK-së propozojmë që të ngritët një komision nga radhët e Kuvendit të Komunës për monitorimin e Drejtorisë përkatëse, përkatësisht hapë pas hapi për gjithë atë që ka paraparë në këtë Hartë Zonale si dhe të jenë edhe këshilltarë të Kuvendit prezent në çdo debat në çdo zonë me qëllim që të jemi në dijeni se çfarë kërkohet nga banorët, çfarë është paraparë, çfarë pranohet dhe çfarë jo, edhe përkundër asaj që në këtë sallë është mbajtur një debat, por për tjera nuk kemi informata.

Pra faktikisht tani po kalon koncepti jonë si opozitë i propozuar dje në KPF që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet sepse nuk është në rregull por që mirë që tani edhe LDK është vetëdijesuar, por për mungesë të numrave jo për diçka tjetër sepse pa keqkuptim por nëse Nënkryetari i Komunës dhe njëkohësisht ushtrues i detyrës së Kryetarit nuk dinë të sqaroj këtë dokument para këshilltarëve të Kuvendit, dhe ju si Kryesues i Kuvendit, unë nuk e di se kush është ai i cili mund të jap sqarime.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, i bashkëngjitëm mendimit të parafolësve që kjo pikë e rendit të propozuar të ditës të shtyhet. Nuk është e vërtetë ajo që u tha se ne si këshilltarë të Kuvendit nuk i kemi marrë CD-të e Hartës Zonale sepse ato i kemi marrë dhe i kemi analizuar, mirëpo për shkak të pakënaqësive të qytetarëve, për shkak të mungesës së drejtorit të Drejtorisë përkatëse dhe për shumë arsye të tjera ne këshilltarët e subjektit AAK sot jemi për shtyrjen e kësaj pike, mirëpo siç po duket e vendosët vetë dhe mirë që po shtyhet.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së kërkoj që në këtë seancë të shtohet edhe një pikë e re në kuadër të rendit të propozuar të ditës lidhur me kërkesën e komunitetit Ashkalinjë drejtuar LVV-së, kërkesë e cila ka të bëjë me zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 04.03.2020 në mes të përfaqësuesit të Drejtorisë së Arsimit z.Agim Blakqori dhe OJQ-së “Zëri i Romëve Ashkalinjve dhe Egjiptasve”-VORAE nga përfaqësuesi z.Isak Skenderi drejtor Ekzekutiv i VOARE, lidhur me qendrat mësimore në të cilat do të vijnë mësimin nxënësit e këtij komunitete, përkatësisht në qendrat mësimore në shkollat fillore “DR Ibrahim Rugova” dhe “Shaban Shala”, andaj meqë janë bërë rreth 8 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes në fjalë zbatimi i saj ka mbet vetëm në letër e që duket se kjo letër është nënshkruar vetëm që të bëhet temë mediatike

meqë në atë kohë ishte edhe fushatë, jo që e bëtë për hallet e këtij komunitete, prandaj ne si Grup i LVV-së kërkojmë që të hyjë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës dhe të zbatohet menjëherë kjo Marrëveshje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa i përket rendit të ditës ne sigurisht që të gjithë e vërejtëm se në emër të të gjitha Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit të të gjitha subjekteve të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës ishte vlerësim se pika e 2-të e rendit të propozuar të ditës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, prandaj unë vë në votim kërkesën / propozimin në fjalë.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri shtyhet për një mbledhje të radhës pika 2 e caktuar në rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përkatësisht;

- Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për përdhën kohore 2020 – 2028

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ashtu patëm një propozim për një pikë shtesë, çështje për të cilën fjalën e kërkon drejtori i Drejtorisë së Arsimit, urdhëroni.

z.Agim Blakqori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DA, theksoi, sa i përket kërkesës së parafolës së znj. Adelinë Stublla dëshiroj t’ju njoftoj se është e vërtetë që kemi një Marrëveshje të Bashkëpunimit me OJQ-në e cekur, mirëpo kërkesa e juaj është e paarsyeshme sepse ne bashkëpunimin me këtë Organizatë nuk e kemi që 8 muaj por kemi bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë që një kohë të gjatë, ndërsa vullneti i Komunës së Podujevës dhe DKA-së është që në të gjitha format t’iu dalim në ndihmë të gjithë nxënësve pa dallime e që këtu bëjnë pjesë edhe ata të komunitetit jo shumicë, përkatësisht atyre që kanë vështirësi të ndryshme në mësim nxënie t’iu krijojmë kushte në mënyrë që të mos mbesim prapa me mësim.

Sa i përket qendrave mësimore, unë vetëm dëshiroj t’ju njoftoj se ne si Komunë nuk kemi bashkëpunim vetëm me OJQ-në VORAE por kemi bashkëpunim edhe me Organizata tjera serioze, me GIZ-in e cila i ka qendrat e tilla në 3 shkollë “Enver Maloku”, “Xheladin Rekalii” dhe “Pavarësia”-Siboc, ndërsa këto dy qendrat të cilat u përmenden nga parafolësja dhe që u kërkuar të hyjë në rend të ditës dhe të diskutohet për të njëjtat, unë ju them që të gjitha obligimet që i kemi marrë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi jemi duke i zbatuar, kemi siguruar hapësirë në të dy shkollat përkatëse, pastaj nuk e di sa jeni të informuar që njëra prej këtyre qendrave ka qenë në komunitet mirëpo për shkak të kushteve jo të mira iu kemi krijuar hapësirë në shkollën “Shaban Shala”, kurse qendra tjetër ekziston që nga fillimi në shkollën “DR Ibrahim Rugova”.

Edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit thuhet që në momentin që këto qendra në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit që e rregullon këtë fushë, të regjistrohen dhe të zyrtarizohen atëherë ne si institucione i marrim mbi vete komplet organizimin dhe menaxhimin e tyre, mirëpo deri në momentin që këto qendra të regjistrohen dhe të zyrtarizohen Organizata në fjalë ka marrë përsipër t’iu siguroj pagën atyre mësimdhënësve/tutorëve, ndërsa DKA ka marrë përsipër që t’i mbështesë në të gjitha format tjera duke iu siguruar hapësirën, qasje në resurset e shkollës përkatëse, lokal të caktuar dhe gjitha çështjet tjera logjistike, e që ne do t’i përkrahim dhe do të vazhdojmë t’i mbështesim, por problemet që i kanë përfaqësuesit e organizatës dhe tutorët mes vete unë nuk mund t’ju zgjidh edhe pse i kam thirr në takim dhe kemi diskutuar me qëllim të gjetjes së një zgjidhje të përbashkët e që krejt ajo që varet prej DKA-së ne jemi të gatshëm dhe do t’i përkrahim ashtu siç jemi duke e bërë edhe me qendrat tjera mësimore, dhe këtë jua kam thënë.

Pra konsideroj se sqarimi që e bëra është i mjaftueshëm për juve dhe për të gjithë, andaj nuk e shohë të arsyeshme që kërkesa për pikë shtesë lidhur me këtë temë të futet në rend të ditës për këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit, falënderoj drejtorin parafolës për sqarimet e bëra rreth kësaj çështje.

z.Fatmir Rudari, theksoi, lus Kryesuesin e Kuvendit që të respektoj rregulloren e punës së Kuvendit sepse këtu u parashtrua një propozim për futjen e një pike të re në kuadër të rendit të ditës për të cilën pastaj u zhvillua debat sikurse ajo pikë të kalonte paraprakisht, prandaj nuk po është e qartë se a kaloj ajo pikë apo ende ka mbetur propozim i LVV-së.

Njëkohësisht lusim edhe këshilltaren në fjalë por edhe të tjerët që herëve tjera paraprakisht të njoftohemi në mënyrë që të kemi paska material dhe të marrim informata.

Ne si Grup i PDK-së jemi që kërkesa e koleges nga LVV të hyn në rend të ditës, por do të donim dhe do të ishte më mirë që paraprakisht të posedonim edhe materialin se për çfarë do të diskutojmë.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolësit, theksoi, konsideroj se kur ndokush e potencon dhe e konstaton në një formë se nuk është bërë asgjë për ndonjë çështje të caktuar siç ishte rasti për këtë temë, atëherë është e natyrshme që secili drejtor i Drejtorisë të jap edhe sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme. Si do që të jetë unë e hedh në votim propozimin për futjen në rend të ditës pikën e propozuar nga znj.Adelinë Stublla.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota për, 12 vota kundër dhe 1 votë e përmbajtur, mbështetet kërkesa / propozimi në fjalë, përkatësisht

- Kërkesë për zbatimin e marrëveshjes se nënshkruar nga Drejtoria E Arsimit dhe Organizata Joqeveritare VORAE lidhur me funksionalizimin e dy shkollave për nxënësit e komunitetin jo shumice.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës përfshirë edhe plotësim ndryshimet e miratuara dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur një ditë më parë.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, por me plotësim ndryshimet, dhe atë:

- *Hiqet nga rendi i ditës pika 2 - propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për përrudhën kohore 2020 – 2028 (renditja e pikave bëhet sipas radhës)*
- *Futet pikë e re shtesë në pikën 9 – kërkesë për zbatimin e marrëveshjes se nënshkruar nga Drejtoria E Arsimit dhe Organizata Joqeveritare VORAE lidhur me funksionalizimin e dy shkollave për nxënësit e komunitetin jo shumice (pika Të Ndryshme kalon në pikë 9)*

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më 09 shtator 2020 dhe 29 shtator 2020

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi 2 procesverbale nga dy mbledhjet e kaluara të Kuvendit dhe sigurisht që keni pas mundësi dhe kohë t'i lexoni, andaj nëse ndokush ka diçka rreth tyre urdhëroni, nëse jo unë e kam një vërejtur një gabim teknik në procesverbalin e datës 29 shtator 2020, përkatësisht në faqet 13 dhe 14 janë disa shuma financiare të cilat nuk janë të qarta (janë të hijezuara) andaj kërkoj të rregullohen para se i njëjti të publikohet.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më 09 shtator 2020 dhe 29 shtator 2020, me rekomandim që të bëhet rregullimi i shumave financiare, të hijezuara, në faqen 13 dhe 14 të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29 shtator 2020

2. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit – DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë sigurisht keni vërejtur propozim vendimin si dhe kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë për vazhdimin e subvencionimit të shpenzimeve të varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës për një periudhë kohore deri më 31 dhjetor 2022, meqë në vendimin paraprakë i miratuar në këtë Kuvend është paraparë vetëm deri më 31 dhjetor të këtij vitit që jemi. Pjesë e këtij propozim vendimi është edhe çmimorja e shërbimeve ku përfshihen transporti, flet lajmërimet, dërrasat, piramida, vend pastrimi, pastrimi, mbulesa, e të tjera, ku në total shuma e shpenzimeve arrin 195 € për një rast, e që të gjitha këto janë vetëm vazhdim nga ajo që janë miratuar edhe më parë.

Vlen të theksohet se Komuna e Podujevës brenda një viti fiskal bënë subvencionimin e shpenzimeve të varrimit rreth 100,000.00€, prandaj kërkoj nga ky Kuvend që të miraton këtë propozim vendim në mënyrë që të vazhdohet me subvencionimin e shpenzimeve të varrimit në vitet 2021 dhe 2022.

z.Hasan Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim vazhdimin e këtij projekti, respektivisht propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit sipas asaj që thuhet në dokumentacion dhe që drejtori parafolës e paraqiti.

z.Vendenis Lahu, theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së e mbështes propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës dh krahas kësaj do të doja që Komuna t'i kushtoj një kujdes më të madh mirëmbajtjes së varrezave gjithandej territorit të Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-ës e mbështesim kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, kërkesë të cilën e kemi përkrahur edhe në të kaluarën.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, në emër të Partisë së Drejtësisë e mbështesim këtë propozim vendim.

z.Avni Islami, theksoi, edhe unë në emër të Partisë së Ballit Kombëtar Demokratik e mbështes këtë propozim vendim sipas materialit përkatës.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, vazhdimin e Marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame-KBI në Podujevë, gjegjësisht kontratën për marrjen përsipër shpenzimet e varrimit për të vdekurit në Komunën e Podujevës sigurisht që ne si subjekt AAK dega në Podujevë do e mbështesim, fundja, çdo veprim që ka për qëllim ndihmën për qytetarët zotohemi se do ta mbështesim ashtu siç e kemi bërë në vazhdimësi si dhe gjithherë do të jemi për lehtësim dhe përmirësim të kushteve si dhe adresimin dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve e që është parim dhe synim i jonë si subjekt politik. Gjithashtu më duhet të potencoj diçka që shumë herë më ka rënë të dëgjoj dhe të debatoj me qytetarët e që ka të bëjë me formën e mbledhjes së anëtarësisë nga ana e KBI në Podujevë, andaj krejt miqësisht, duke e ditur rolin dhe kompetencat e mia në cilësinë e përfaqësueses së qytetarëve do të apeloja te KBI-Podujevë të shqyrtohen mundësitë dhe format më të përshtatshme për inkasim të anëtarësisë. Praktika që në ditën e vdekjes dhe varrimit për të marrë shërbimet fetare të kushtëzohet me shlyerjen e obligimeve disi po del situatë e rënduar për të afërmit dhe familjarët që kanë raste vdekjeje. Jam në dijeni se feja është e ndarë dhe jemi shtet laik dhe nuk kam qëllim dhe as synim të ngatërrohem me këtë, por qëllimi im është miqësorë i cili fillon dhe përfundon këtu, mirëpo ngritja e kësaj çështjeje dhe besimi i qytetarëve fundja na ka bërë që ne këtu të jemi si rezultat i votave dhe besimit të qytetarëve andaj ndihma dhe përkujdesja ndaj qytetarëve në momente të rënduara me rastin e vdekjeve të anëtarëve të familjeve të tyre që po bëjmë ne si institucion dhe si

Komunë disi pastaj po ngarkohet me këtë formë të inkasimit të anëtarësisë, mirëpo Komuna dhe ne si Kuvend mund edhe të paraqesim alternativa përkrahë qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës

3. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

- *Propozim vendimi për miratimin e nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*
- *Propozim vendimi për autorizimin e fillimit të konsultimeve për binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sigurisht që materialin për këtë pikë të rendit të ditës keni mund ta analizoni, bëhet fjalë për një nismë të bashkëpunimit komunal me qytetin Ames të shtetit të Iowa të SHBA-ve. Bashkëngjitur kësaj nisme në aspektin procedural janë edhe dy propozim vendime të cilat hapin rrugë për një bashkëpunim të tillë dhe finalizim të binjakëzimit, andaj ftoj për një fjalë hyrëse Nënkryetarin z.Nexhmi Rudari i cili edhe është Kryetar në detyrë i Komunës së Podujevës.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës dhe njëkohësisht në cilësinë e ushtrimit e detyrave dhe kompetencave të Kryetarit të Komunës, paraqiti fjalën hyrëse lidhur me kërkesën në fjalë përkatësisht dy propozim vendimeve sipas kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, ka një kohë bukur të gjatë që jemi në negociata me Kryetarin e Bashkisë të Qytetit Ames në Shtetin e Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kemi shkëmbyer bukur shumë korrespondencë përmes e-maileve dhe e gjithë ideja ka ardh si iniciativë e Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës znj.Doruntina Maloku e cila ka pasë një vizitë në shtetin e Iowa bashkërisht me një Grup të Deputetëve e që pastaj është përmendë mundësia që Podujeva të binjakëzohet me Qytetin Ames dhe kemi filluar shkëmbimet dhe korrespondencën me Kryetarin e këtij Qyteti dhe përfaqësuesit tjerë.

Po ashtu dëshiroj t'ju njoftoj se në muajin mars ka qenë e paraparë një vizitë e përfaqësuesve të Ames në Komunën e Podujevë por fatkeqësisht për shkak të shfaqjes së pandemisë Covid-19 por edhe për faktin që ishte kohë fushate jemi marrë vesh me përfaqësuesit e qytetit Ames që kjo vizitë të shtyhet për një kohë dhe periudhë kohore më të favorshme, mandej ata kanë bërë ftesë që ne t'i vizitojmë në muajin qershor mirëpo sërish kam menduar që nuk do të ishte e arsyeshme që në kohë pandemie të realizojmë një vizitë të tillë në SHBA me qëllim të fillimit të negociatave zyrtare për binjakëzim me qytetin Ames.

Edhe këto ditë jam në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e këtij qyteti, pothuajse të gjitha procedurat e Marrëveshjes së mundshme për binjakëzim kanë përfunduar, me përjashtim të miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës të këtyre dy propozim vendimeve që keni paravetës si konfirmim që jemi të interesuar, e që besoj se të gjithë jemi të interesuar për një gjë të tillë, ngase interesimi i dy qyteteve për binjakëzim është edhe për shkak të disa specifikave të përbashkëta që kemi sepse Ames

është një vend shumë i zhvilluar agrikulturore e që edhe Podujeva po ashtu ka synim që agrikulturën ta ketë si pikë të parë dhe më të rëndësishmen si shtyllë e zhvillimit ekonomik.

Nëse kjo nismë miratohet dhe nëse unë autorizohem nga ana juaj që të zhvilloj dhe përfundoj negociatat unë besoj që në pranverën e vitit të ardhshëm, sepse tani jemi në pandemi dhe nuk i dihet situatës, do të mund të kurorëzohem me nënshkrimin e Marrëveshjes finale e që në fakt Kuvendi i Qytetit Ames e ka miratuar si propozim por që presin vetëm edhe miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Afrim Shabani, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahim kërkesën, respektivisht propozim vendimin për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për fillimin e konsultimeve për binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit Iowa në SHBA.

z.Pajtim Balaj, theksoi, e di që punën e binjakëzimit deri më sot e keni paraqitur si storie suksesi sikurse që edhe sot që në fakt duhet të jetë, por jo vetëm si reduktim i saj vetëm me një proces të nënshkrimit të marrëveshjes por si mundësi bashkëpunimi dhe si mundësi përfitimi për Komunën dhe qytetarët tanë. Dua të pyes se në deri në çfarë niveli ka shkuar bashkëpunimi me Komunitet tjerë me të cilat Komuna jonë është binjakëzuar. E dimë pompozitetin e paraqitjes së nënshkrimit të marrëveshjes me Komunën e Velbert të Gjermanisë por nuk dihet se çfarë është bërë tutje, sa dhe si ka përfituar Komuna jonë nga ky binjakëzim në këmbim përvorash, ndihma tjera administrative teknike apo të tjera. E dimë që ideja kryesore e binjakëzimit është kryesisht shkëmbimi i përvorave dhe ndihmave eventuale por duke qenë se në këtë situatë ne jemi më shumë palë marrëse për shkak të gjendjes tonë ekonomike dhe politike, a mund të na tregoni se sa shkëmbime kemi pasë deri më sot dhe a keni vendosur prioritete në këto shkëmbime, apo thjeshtë i keni reduktuar në shkëmbime vizitash të zyrtarëve komunal, praktik kjo goxha e zakonshme në vendin tonë.

Përtej të mirave që mund t'i kenë ardhur Komunës tonë nga këto binjakëzime, a mund të na shpjegojnë se sa ka shpenzuar Komuna në shpenzime të vizitave Komunitet me të cilat jemi binjakëzuar në mënyrë që t'i balancojmë përfitimet dhe humbjet nga këto binjakëzime, dhe kur e them se sa ka shpenzuar Komuna në këto vizita konkretisht e kam interesin në mëditjet që i kanë marrë zyrtarët Komunal pasi që prapa këtyre vizitave në shumë raste qëndron dëshira për të marrë sa më shumë mëditje dhe për të kaluar sa më shumë ditë jashtë vendit.

Keq që sot nuk e kemi të pranishëm ish drejtorin e shkaktuar z.Hamdi Jaha sepse të paktën atë do ta pyesja se si ka kaluar në vizitën e fundit në Velbert, e që në fakt krejt çka dimë nga binjakëzimi me Komunën e Velbertit, apo përfitimin e vetëm është vetëm vizita e drejtorit të shkarkuar dhe ish Kryetarit të vetëshkarkuar zotëri Veliu, vizitë që ata e kanë pasur në Velbert përkundër asaj që nënshkrimi i Marrëveshjes ishte paraqitur në atë kohë me pompozitet si mundësi e bashkëpunimit dhe përfitimit në shumë fusha.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, tani unë e kuptoj se jemi në një situatë fushate dhe gjithçka ka interes që të diskutohet në këtë frymë fushate, por që për mua edhe kjo është në rregull dhe nuk paraqet ndonjë problem.

Sa i përket binjakëzimit të Komunës së Podujevës me qytetin Velbert ne kemi pasë shkëmbime të vizitave, madje kanë ardh disa herë disa klube të ndryshme sportive për vizitë në Podujevë, po ashtu Klubi Futbollistik Llapi ka qenë mysafirë në një ligë/garë të cilën e organizon ajo pjesë e Gjermanisë e që fatmirësisht djelmohet tanë në një garë bukur të fortë kanë arritur të zënë vendin e parë në futboll, e që nuk është vetëm kjo por është shkëmbim kulturorë, sportiv edhe arsimorë. Do të thotë pjesa sportive ka nisë fillimisht me të rinjtë sepse ka të bëjë me të rinjtë, ndërsa pjesa kulturore ka qenë e paraparë të ndodh këtë vit por për shkak të pandemisë të gjitha projektet e shkëmbimit që kemi pasë për vitin 2020 për momentin janë pezulluar, kurse sa i përket përfitimeve të tjera të mundshme ne kemi pasë edhe donacione prej Qytetit të Velbert për Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare (shtretër dhe pajisje të tjera) e që ju them se ky bashkëpunim do të ishte shumë më produktiv po të mos ishim në një periudhë të pandemisë globale dhe deri sa të përfundoj kjo situatë me Covid-19 si pandemi sigurisht që nuk do të kemi mundësi as t'i presim ata për vizitë në Komunën e Podujevës e që kanë pasë shumë projekte për Komunën e Podujevës por as nuk do të mund të realizojmë projektet e parapara në kuadër të binjakëzimit me Qytetin Velbert ngase në vitin 2020 ka qenë e paraparë që një numër i madh i studentëve dhe i nxënësve të Gjinnazit “Aleksandër Xhuvani” sepse ky institucion shkollorë në kuadër të kësaj marrëveshje të binjakëzimit, është binjakëzuar me një institucion shkollorë të këtij Qyteti dhe që është dashtë të shkojnë për vizitë rreth 20 nxënës tanë por që pandemia ka pamundësuar një gjë të tillë, me shpresën që kjo të përfundoj këtë vit dhe vitin e ardhshëm të gjitha projektet e përbashkëta që kemi me Velbert do të realizohen. Komuna e Podujevës në këtë rast nuk ka obligime financiare me përjashtim të transportit që duhet ta bëjmë në raste të vizitave, gjë e cila ka ndodhur edhe me Klubin “Llapi”, kurse të gjitha shpenzimet tjera i ka dhe do t'i ketë qyteti Velbert.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim fillimin e procedurave të binjakëzimit me Qytetin Ames të shtetit të Iowa të SHBA-ve, duke shpresuar që në të ardhmen të ketë më shumë rezultate në bashkëpunime të dyanshme.

z.Pajtim Balaj, theksoi, Nënkryetari i Komunës e tha që po e përdorim për fushatë, por ne nuk e kemi sjellë këtë pikë të rendit të ditës në kohë fushate, ju e keni sjellë. Ne bëjmë politikë këtu me dijen dhe mënyrat tona, kurse për fushatë ne shohim se ju çdo ditë bëni fushatë me punë dhe shërbime publike që ju duheni t'i kryeni për 4 vite ndaj qytetarëve, pra fushatë ju bëni çdo ditë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 29 vota për, asnjë votë kundër dhe 1 votë të përmbajtur (Doruntina Hasani), u miratua Nisma e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

- *Propozim vendimi për miratimin e nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*
- *Propozim vendimi për autorizimin e fillimit të konsultimeve për binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

4. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën nëntëmujore janar – shtator 2020

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, qëllimi i këtij raporti është për të prezantuar aktivitetet financiare për këtë periudhë, me theks paraqitjes së një informate të shkurtër lidhur me shpenzimet në nivel të organizatës të ndara sipas kategorive ekonomike dhe sipas burimit të financimit duke bërë edhe një krahasim me të gjitha llojet e shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë kanë arritur shumën prej 14,839,864.00€, dhe atë paga dhe mëditje 9,057,940.00€, ku prej tyre 154,800.00€ për Covid-19 faza e parë, mallra dhe shërbime 1,096,371.00€, prej tyre 374,580.00€ për Covid-19 po ashtu faza e parë, shpenzime komunale 202,033.00€, subvencione 577,771.00€ prej tyre 135,000.00€ për Covid-19, investime kapitale 3,905,749.00€, shpenzime këto në kuadër të planifikimeve për këtë periudhë kohore, duke përjashtuar shpenzimet e paplanifikuara të shkaktuara

si rezultat i pandemisë dhe nëse bëjmë një krahasim të shpenzimeve të kësaj periudhe me atë të një viti më parë atëherë vërehet se ka një rritje të shpenzimeve afër 13%.

Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake përgjatë kësaj periudhe e të cilat janë të paraqitura në tabelën e të hyrave, dhe atë inkasimi i të hyrave vetanake komunale janar – shtator 2020 është 958,802.00€ shumë e cila përfshinë në total të hyrat direkte, ato inderikte, donacionet e jashtme dhe ato të brendshme. Natyrisht që në këtë realizim të të hyrave direkte ka një rënie të theksuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak për shkak të pandemisë e cila ka pasë efekte negative në të gjitha aspektet e jetës si një ecuri jo normale dhe si rezultat i kësaj ka qenë edhe Vendimi i këtij Kuvendi të Komunës që për këtë vit bizneset të lirohen nga ngarkesat e taksës në firmë dhe lirimi nga obligimet për bizneset dhe ata që shfrytëzojnë pronat komunale për vitin 2020 e që bazuar në planifikimin e të hyrave për këto dy kategori shuma e liruarr arrin në vlerën rreth 230,000.00€, mirëpo edhe përkundër kësaj pagesat e qirave për vitet e kaluara kanë vazhduar dhe kemi një inkasim modest rreth 30,000.00€.

Në këtë periudhë raportuese kemi realizuar një donacion në vlerë prej 69,920.00€ nga Qeveria Japoneze për Njësinë e Zjarrëfikjes, përkatësisht blerjen e një kamioni zjarrëfikës, si dhe një participim prej qytetarëve në projekte të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vlerë 77,512.00€.

Për fund mund të konstatojmë se është një raport i cili paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe të dalave për këtë periudhë raportuese. Janë bërë disa lëshime teknike kur bëhet fjalë për periudhën ku në disa raste thuhet raporti financiarë janar – qershor 2020 e që do të duhej të ishte janar – shtator 2020, për çka kërkoj ndjesë por që këto gabime do të korrigjohen dhe raporti do të publikohet i korrigjuar me këto lëshime teknike.

z.Adnan Zymeri, theksoi, raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2020 paraqet raportin me strukturën, shpenzimet dhe alokimet më të pa zakonta ngase edhe periudha kohore për të cilën jepen detaje në këtë raport ka qenë periudha më e pazakontë në të cilën po kalojmë si shoqëri pavarësisht se ky fakt për ndokënd mund të konsiderohet pa peshë, por kush ka dëgjuar për politikën makro të ekonomisë e kupton edhe ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe transaksionet brenda secilës organizatë, institucion apo Qeveri.

Paralizimi i jetës që ka shkaktuar Covid-19 gjatë pjesës më të madhe të kësaj periudhe raportuese ka reflektuar me ngecje të të gjitha aktiviteteve nga të cilat Komuna përfiton pjesën më të madhe të inkasimit të të hyrave vetanake. Situata nëpër të cilën kaluam dhe po vazhdojmë të jemi ende ka ndryshuar pasqyrën në kategori të ndryshme buxhetore, si në rastin e mallrave dhe shërbimeve në të cilën kategori brenda zërave të caktuar financiarë janë rritë shpenzimet duke marrë parasysh furnizimet që është dashtë të bëhen, sidomos në Drejtorinë të cilat kanë qenë të përfshira direkt në luftë me coronavirusin Covid-19 dhe me mirëqenien e qytetarëve.

Në këtë kohë janë duke u zhvilluar projekte të shumta të investimeve kapitale të cilat në periudhën e ardhshme raportuese do të ndikojnë që planifikimet me shpenzime do të jenë më të përafërta.

Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë këtë raport duke kërkuar intensifikim të aktiviteteve dhe dinamikës së punëve për t'iu ofruar sa më shumë realizimit të planifikimeve.

z.Avni Fetahu, theksoi, LVV e ka analizuar me kujdes raportin financiar për periudhën janar – shtator 2020, duke marrë parasysh formën se si është keq menaxhuar paraja publike në këtë periudhë kohore nga ky Ekzekutiv, nga një Nënkryetar (që iku nga këtu e që do të ikë së shpejti) i cili në zgjedhjet e fundit me zero vota ka qenë kurse udhëheqë Komunën, ne si subjekt i LVV-së në vazhdimësi e kemi potencuar se raportet financiare të sjella me këtë përmbajtje aktuale në Kuvend nuk i përmbushin as kriteret ligjore të një organizate buxhetore siç është Komuna, kështu që gabimet teknike ju falen, por nuk ju falet mos transparenca dhe publikimi i qartë i raportit financiar, të

kapshëm edhe për qytetarët por edhe për asamblistët. Ky raport përmban vetëm shuma totale të shpenzimeve për kategori të ndryshme ekonomike dhe në asnjë faqe të tij nuk përfshinë detajet e nevojshme. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, raportet përveç tjerash duhet të përfshijnë mbishkrimin e ndonjë suficidi apo deficidi buxhetor, në të njëjtën kohë duhet të paraqesin edhe projektet, detajet e pagesave, borxhet etj. Sa i përket Drejtorive është shqetësuese, shikojeni në faqe të Komunës, nëse e gjeni ndonjë plan të punës të ndonjë drejtori, unë ju kam borxh çfarë të doni, përkundrazi asnjë plan i punës i asnjë drejtori nuk është i bashkëngjitur në faqe të Komunës, e që një plan i punës do të mundësonte realizmin e projekteve me kohë dhe njëkohësisht do të na lehtësonte neve të shohim se çfarë ka planifikuar Ekzekutivi i Komunës dhe çfarë ka realizuar, kurse për kureshtjen e juaj asnjë Komunë tjetër nuk e gjeni që nuk i kanë të pasuara këto plane (këtu i kam të shtypura) madje edhe planet mujore i kanë të bashkëngjitura e lëre më ato vjetore, ndërsa Komuna jonë nuk i ka.

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 2 paragrafi 2.1, sqarohet qartë se paraja publike është para e cila i jepet në mirëbesim Ekzekutivit të Komunës, ndërsa shtrohet pyetja se në çfarë mirëbesimi i është dhënë paraja publike këtyre kur i eliminojnë operatorët më të lirë ekonomik, i neglizhojnë bizneset që janë serioze dhe i shtinë të shkojnë të kryejnë aktivitetin e vet biznesor nëpër komuna tjera.

Kjo formë e raportimit që është sjellë këtu para nesh, fillimisht e tregon planifikimin e dobët, mandej edhe realizmin e dobët të punëve dhe rrjedhimisht si rezultat i kësaj vie edhe një raport i dobët e që për të argumentuar këtë unë po i paraqesë disa argumente të cilat janë edhe për prokurorinë, edhe për media por që ta dinë edhe qytetarët e Komunës tonë. Rasti i shkollës “Elfir Behrami” në Metehi po e sqaroj me dokumente, për këtë shkollë është interesant që në vitin 2019 (ky dokument është edhe prej Komunës) ku këta kanë planifikuar edhe hartim të projektit për këtë shkollë dhe është normale që është bërë një projekt i tillë, i cili projekt ka kushtuar 1846.00€ i realizuar nga “Studio Hapësira” kompani kjo e njohur për Ekzekutivin këtu, mandej janë zhvilluar procedurat e prokurimit për këtë shkollë dhe është zgjedhë kompania e njohur për ne këtu dhe për mediat qo do t’jua jap e cila kap vlerën 388,444.00€ dhe shikoni tani si ndodh vjedhja këtu me “jaka të bardha” nga ky Ekzekutiv, pasi hartohet projekti, zhvillohen procedurat, shpallet kompania fituese dhe nuk është e kënaqur me çmimin sepse e dinë se nuk mund ja del dhe pastaj menaxheri i projektit i thot mos ki dert ti se kur të vie viti 2020 ti qesim ne edhe 26,332.95€ e që mund të shikoni se në vitin 2020 kontrata iu ka dhënë të njëjtës kompani me këtë shumë për atë projekt, madje i kanë qitë edhe centat gjoja aq të përpiktë që janë, kurse që i vjedhin milionat gjale nuk e kanë.

Rasti tjetër edhe më eklatant dhe më i dhimbshëm për qytetarët e Komunës tonë është autoambulanca e blerë nga Komuna e Podujevës, në planin përfundimtar të prokurimit kanë planifikuar saktë për të blerë një autoambulancë në vlerë prej 60,000.00€, të jemi të kuartë LVV nuk është kundër blerjes së këtyre autoambulancave por është për t’i zhvilluar procedurat drejt dhe korrekt ashtu siç parashihet me ligj, mirëpo këta i kanë zhvilluar procedurat e negocimit, procedura të cilat jua kanë mundësuar këtyre që të blejnë atë autoambulancë me 59,840.00€, afër 60,000.00€ e që kjo nuk është rastësi, por këtu nuk përfundon puna sepse krimi më i madh është pikërisht këtu sepse Komuna e Podujevës blen autoambulancë me 60,000.00€ kurse të njëjtën autoambulancë me të njëjtat specifika Komuna e Mamushës e blen me 38,340.00€, pra 21,500.00€ më lirë.

Në të dyja rastet e lartcekura problemi kryesor qëndron tek mungesa e publikimit të ofertave financiare e cila e pasqyron para masën dhe para llogarinë, mungesë e cila pasqyron korrupsionin real të Organizatës buxhetore siç është Komuna.

Se mungesa e transparencës prodhon korrupsion, po ju jap shembullin konkret, mospublikimi i projektit dhe ofertave financiare për ndërtimin e rrugës “Zahir Pajaziti” ku ishte i paraparë në projekt

vendosja e gypit për ngrohje qendrore nga ish “Hotel Besiana deri te kafiteria “Pranvera” , menaxheri i projektit, kompanisë që ka dashtë t’ia jap tenderin i ka thënë këtë pozicion qite më lirë, pozicion i cili ka qenë i paraparë të kushtoj 200,000.00€ por që nuk është vendosë edhe pse është lëvruar ajo rrugë dhe do të lëvrohet sërish kushdo që është në qeverisje sepse ajo pjesë e banorëve nga Restelicët e tutje është në rritje e sipër dhe nuk e di si do të nxehen andaj po e them se do të vie koha kur do të vendoset gypi i nxemjes, dhe ajo kompani e ka qitë çmimin më të ulët me qëllim që ta fitoj tenderin dhe më vonë i kanë thënë nuk ke nevojë ta vendosësh hiq këtë sepse e kanë heq prej pozicioni, qëllimi ka qenë vetëm si të futet më i lirë dhe të shpallet përfitues i tenderit.

E kam analizuar dhe nuk ka ndonjë industri e cila është zhvilluar në Komunën tonë se sa kjo industria e korrupsionit në krye me menaxherin e prokurimit dhe zyrtarët tjerë, sepse kjo vetëm nuk bëhet po ekziston një klikë më e gjerë, andaj e vetmja gjë që kam mundur të analizoj në këtë raport financiar është vetëm nëse e bëjmë një krahasim me planin përfundimtarë të prokurimit të cilin janë bërë pishman pastaj përse e kanë publikuar, plan në të cilin shikoni se çfarë po shkruan, këtë plan të prokurimit me numër rendor 76 shkruan, furnizime me materiale të imta ndërsa paramendojeni vlera e materialeve të imta është 38,000.00€, dhe tani lehtë është të harxhohen paratë pa lidhje dhe të mundohet t’i arsyetoj edhe më pa lidhje pastaj përmes kodeve, shërbime kontraktuese tjera, dhe kur jemi te këto shërbime shikoni sa interesante është, në numrin rendor 61 te plani përfundimtar i prokurimit është shuma prej 121,646.00€ plus 2000.00€ më vonë që bëjnë 123,646.00€, ndërsa në këtë raport financiar që na e kanë sjellë këta i kanë harxhuar deri tani 473,363.79€ të emërtuara vetëm si shërbime kontraktuese tjera, të jemi të kjashtë, këtu nuk ka gabim teknik por ka vjedhje të buxhetit. Mandej këtë plan përfundimtarë të prokurimit e gjeni edhe sistemin digjital për votim i cili është planifikuar me një shumë prej 40,000.00€, kurse tani ju pyes a ka ndonjë këtu që ka votuar ndonjëherë në formë digjitale.

Për të mos paraqitur krejt zi, është diçka për tu përshëndetur, ka qenë e planifikuar dhe është realizuar blerja e disa makinave për pastrimin e dysHEMEVE në shkollë, paramendojeni pas 20 viteve është heq çebja e që është një sukses goxha i madh ky, dhe atë çebe për kureshtje e shikoja një ditë punëtorin teknik duke e shikuar si me mallëngjim, e të cilit i thash përse nuk po e heq sepse e keni makinën tani, më tha kam frik se sërish duhet t’i kthejmë çebet, e që me veten thash nuk e ka edhe keq sepse duke qenë në dijeni kush i kontrakton këto mallra dhe shërbime është e mundshme gjithçka. Pra Komuna e Podujevës përmes këtij raporti nuk është treguar transparente andaj edhe jo rastësisht në të gjitha të gjeturat e organizatave kredibile në Kosovë e renditin në fund sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Për fund, jeni në dijeni se menaxheri i prokurimit bënë pazare me tenderë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave kryen pagesa ende pa ardhur malli (siç është e gjetur e auditorit rreth inventarit së Komunës së re e që as në kohën e UNMIK nuk ka ndodh një gjë e tillë, në atë video lakohet edhe emri i sh Kryetarit dhe drejtorit të DBF Isuf Latifi, i zyrtarëve të prokurimit, dhe këta asnjë masë disiplinore nuk e marrin. Ky shtet i kapur nuk e ndërmer asnjë veprim për këtë veprim që kanë bërë këta, andaj e vetmja formë për t’ju ndal këtë keq qeverisje jeni ju qytetarë të nderuar përmes votës tuaj, prandaj ju lutem mos lejoni të jeni të vjedhur.

z.Bashkim Sylja, theksoi, raporti financiar në përbërjen e tij ka gabime teknike, në faqen e parë thuhet se është raport gjashtëmujor, ndërsa në faqen 5 pika 2 shpenzimet i paraqet si periudhë për janar-qershor 2020, andaj është mira ta dimë a është raport gjashtëmujor apo nëntëmujor.

Buxheti i Komunës për vitin 2020 është 26,765,269.00€ ku për shpenzime kapitale janë miratua 9,432,455.00€. Në nëntë muajt e këtij viti Nënkryetari i Komunës me ekipin e tij kanë shpenzuar për investime kapitale 3,950,749.00€ apo 41% të buxhetit të planifikuar për këtë kategori, ndërsa kur

ja shtojmë edhe shumë prej 1,690,511.00€ nga buxheti për paga dhe mëditje të rialokuara në seancën e kaluar do të jetë shumë vështirë të përmbushet për investimet e planifikuara.

Jemi në dijeni se jemi në kohë pandemie mirëpo duhet të kemi parasysh që kjo qeverisje edhe në vitin 2019 ka pas mbi 2 milion euro suficid.

Për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i kemi disa vërejtje dhe kërkojmë disa sqarime nga ai për disa çështje të cilat i ka paraqitur në tabelat e shpenzimeve, shembull, te kodi për shërbime kontraktuese tjera janë shpenzuar 473,363.00€ ndërsa në vitin paraprak 2019 janë 279,439.00€ e që kjo i bie që 75% më shumë është shpenzuar vetëm në nëntëmujorin e këtij viti sesa në krejt vitin 2019, pastaj te kodi lëndë djegëse shuma 102,544.00€, kurse vitin e kaluar kemi 51,170.00€ që i bie afër 100% më shumë se në vitin 2019, për sheshe dhe hapësira tjera publike janë prezantuar 526,492.00€ kurse te tabela e pagesave firmës “konstruktori” i janë paguar 380,000.00€, do të thotë se për hapësira tjera janë paraqitur se janë paguar 146,212.00€ andaj kërkojmë të informohemi se cilat hapësira tjera janë rregulluar, pastaj kodi 21200 subvencione për entitete jo publike, janë shpërndarë në katër rubrika dhe shuma totale e tyre është 519,877.00€ ndërsa në vitin 2019 janë shpenzuar 106,380.00€ e që diferenca prej viti në vite është 413,493.00€, andaj për të gjitha këto çështje që i ngrita në emër të Grupit të PDK-së, kërkoj nga qeverisja lokale që të na jepen sqarime.

znj. Mrika Thaqi, theksoi, raportet periodike financiare të paraqitura si rend pune në mbledhjet e Kuvendit para së gjithash janë përmbushje e obligimit ligjor për raportim para Kuvendit, kuptohet si informim objektiv lidhur me të hyrat, ecurinë dhe treguesit relevant për përmbushjen e planit të inkasimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjen e obligimeve të planifikuara, realizmin e projekteve të planifikuara dhe miratuara sipas plan programeve, dinamikën e punëve të kryera, mjeteve të shpenzuara sipas kategorive buxhetore, rrjedhjen e mjeteve financiare si dhe treguesit tjerë relevant që kanë pas inpakt në rezultatin e përgjithshëm për këtë periudhë kohore janar-shtator 2020. Për matjen e këtij aktiviteti apo menaxhimi ne do të duhej të kishim pikë referente planin e punës së menaxhmentit apo Ekzekutivit të Komunës, por a kemi pas plane dhe program pune dhe a e kemi pas planin e punës së prokurimit përgjigjen e dimë të gjithë, andaj ne nuk kemi parametra matës, si do çoftë raporti paraqet rrjedhën e parasë publike në realizim të projekteve por pa planifikim të mirëfilltë, konciz, afate kohore të përcaktuara saktë konform kërkesave dhe në plotni konform ligjit, sigurisht që krijon dilema për një menaxhim të mirë.

Pa dashur të zgjatëm në debatim për kategori veç e veç, si emërues i përbashkët më shqetëson fakti i shpenzimit dhe realizmit të buxhetit, uroj të mos kemi suficid buxhetor shkak i kapaciteteve menaxhuese kur dihet mirëfilli dhe kërkesat e qytetarëve, fundja ky buxhet është i tyre por që ne e menaxhojmë, kur them është i tyre mendoj për ata që iu është besuar qeverisja.

Për fund, me vetë faktin që raportet e tilla nuk kanë nevojë për miratim në Kuvend, flet mjaftë për kompetencat tona si këshilltarë/e të Kuvendit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova parafolësit (industrinë e pagesave që e ceku zotëri Fetahu, që ishte paksa interesante), por edhe fjalimin e këshilltarit z. Adnan Zymeri, dhe duke mos dashur të hyjë në debatet e tyre, por meqë po debatohet për pagesa interesante do t'i drejtohem këtij të fundit meqë ky i fundit e tha se kush e kupton makroekonominë, sigurisht që të gjithë nga pak e kuptojmë, madje dikush edhe më mirë, por i kuptojmë edhe formate pagesave ligjore dhe të kombinuara e që do t'i përmend disa pagesa shumë interesante për mua si jurist.

Meqë e përmende pandeminë dhe si kohë jo e mirë, 14 € janë paguar një palë doreza nga kjo Komunë, 28 € një palë rroba njëpërdorimshme nga qesja, kurse këto të dyja bashkë kushtojnë 5 € në cilëndo barnatore që hynë, pa shkuar në depo. Do të thotë janë pagesa interesante këto për mua, meqë është pandemi dhe populli ka nevojë, kjo nuk është makroekonomi por është kontratë e veçantë në kushte të veçanta. Pastaj tjetra, për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve në vitin

2019 ka qenë shumë prej 17,122.00€, kurse në këtë vit është 17,467.00€ që do të thotë se automjetet janë prishur në të njëjtin vend dhe në të njëjtin vit, gjë kjo e cila është shumë interesant kush do që ta kuptoj sepse kemi prishje të njëjtë për automjete dhe mirëmbajtje është e njëjtë në të njëjtin vit. Mandej kemi pagesën tjetër për mirëmbajtjen e mobileve dhe pajisjeve ku nj pagesë është 4018.00€ ndërsa kemi pagesën tjetër të dytë në shumë 29,247.00€ që janë për mirëmbajtje rutinore sipas nevojës e që do të thotë se afro 40 mijë euro për këta nëntë muaj janë paguar për riparime dhe mirëmbajtje, ndërsa ne kemi hyrë qe 3 muaj në objektin e ri të Komunës me gjithë inventarin, gjë e cila po ashtu është shumë interesante për makroekonomi që ta dimë zotëri Adnan.

Subvencione për entitete jo publike shuma 237,877.00€, nëse ju e kuptoni zotëri Zymeri mirë nëse jo e sqarojmë sërish, pastaj për shpenzime për vendimet gjyqësore janë paguar 80,000.00€ me taksën e kamatës prej 8% që i bie pagesë shtesë sipas ligjit përkatëse për pagesa të dhunshme që bëhen përmes thesarit për ato pagesa që Komuna nuk i ka kryer ndaj operatorëve ekonomik të cilët vetë Komuna i kontraktuar, dhe kjo është interesante në kohë pandemie, madje mund ta kalkuloni shumën prej 8% shtesë në shumën e cekur. Mandej kemi subvencionimin e OJQ-ve për të cilën keni marrë vërejtje publike prej një personi të pavarur të Auditorit të brendshëm, pa plan, për pagesa fiktive si dhe asnjë OJQ nuk ka sjellë plan të punës në koordinim për përcjelljen e OJQ-ve këtu në komunën e Podujevës, gjë për të cilën mund të merrni informacione në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave dhe t’jua kërkon planin atyre se për çka janë dhënë ato mjete, unë deri diku e di por mund ta pyesësh ti Adnan. Pastaj për garazhdim janë paguar 30,000.00€ për të cilën po ashtu është mirë të na jepni sqarime, mirëpo kemi edhe 5000€ për shpenzime telefonike kurse në pandemi Komuna ka punuar me staf emergjent/esencial, sidomos në kohën e karantinimit të disa fshatrave deri në lirim të tyre. Shpenzimet e automjeteve janë dyfishuar, mirëmbajtja është dyfishuar, veturat në parking, pastaj shpenzimet e telefonisë janë dyfishuar, prandaj gjitha këto pagesa janë mikroekonomike sepse i gjithë buxheti i Komunës është rreth 7 milion euro, kurse i nderuar Adnan për makroekonomi është buxheti në nivel vendi, kështu që Grupi i këshilltarëve të PDK-së nuk e voton dhe nuk e miraton këtë raport të pagesave (edhe pse ky raport nuk votohet) sepse nuk mund të arsyetoj askush këto pagesa, përjashtimisht disa pagesave e që do të kryhen edhe në tremujorin e fundit për rrugë dhe rrugica që Nënkrjetari po del po i viziton, madje nëse shikohet rruga Sfeçël – Shajkoc – Batllavë mund të shihen rrugë dhe rrugica të cilat do të paguhen këtë vit, ka të atilla ku deri në oborret e shtëpive në të cilat ende nuk janë kryer punët e vrazhda e që pastaj operatori kërkon pagesat ose do të ndodh të rëndohet buxheti i Komunës, madje madje ky Nënkrjetar dhe ish Kryetari e kanë sjellë në Kuvend për miratim prioritetet të cilat janë nxjerrë nga debatet me qytetarë, por që të gjitha kanë ndërruar dhe askush nuk ka ngritur zërin këtu, as nga Ekzekutivi i Komunës që këto rrugë që janë duke u shtruar asnjëra prej tyre nuk janë në prioritet të Komunës që janë miratuar.

z.Adnan Zymeri, theksoi, më vie shumë mirë që kolegu zotëri Llapashtica paska dëgjuar edhe për makroekonomi si dhe terme tjera, mirëpo unë nuk mbajta ligjëratë që t’ju tregoj juve se me çka merret makroekonomia si jurist që je (i drejtohet Rafet Llapashticës) por vetëm tregova ndikimin që e ka faktori i jashtëm që është në pandemi dhe që ka ndikuar, mirëpo unë e vëreja që ju qëllimisht e nxjerrët nga konteksti këtë çështje e që është krejt në rregull sepse jemi në fushatë dhe gjitha këto çështje janë të pritshme, dhe patjetër që ka pas ndikim.

Sa i përket keqpërdorimeve që u cekën, ku do që vlerësoni s ka pas keqpërdorime unë ju ftoj t’i raportoni sepse për ata jemi këtu, për aktakuza, për kallëzime penale e gjëra tjera që i përkasin juridikut e që unë nuk ma shumë vesh, por ti zotëri Llapashtica si përfaqësues dinjitoz që jeni dhe i gjithëdijshëm në shumë tema, unë jam paksa më specifik dhe nuk diskutoj shumë për nga juridiku, mirëpo jam i gatshëm që të bardhës t’i them të bardhë kurse të zezës të zezë dhe t’i kontribuoj këtij

qëllimi, pastaj t'i dërgoni keqpërdoruesit që ti i paske identifikuar, nëpër gjykata dhe të mos i lëni të gjitha në nivel të fjalëve.

z.Rafet Llapashtica, i drejtohet Adnan Zymerit, theksoi, çka ndodh këtu e dimë të gjithë, nuk ka njeri që e arsyeton video incizimin e zyrtarit të prokurimit Rasim Fejza në kafe, i cili është nga subjekti LDK edhe pse mua nuk më intereson shumë subjekti por institucioni dhe shteti, çështje e cila del në media publike dhe nuk ndërmer askush asgjë e lëre më t'i Adnan sepse nuk mund të bësh asgjë sepse nuk keni ndikim as në subjektin e juaj politik, por duhet të veprojnë institucionet shtetërore dhe në qoftë se dëshirojmë të ecim përpara kjo Komunë ka nevojë për një njeri i cili merr vendime. Nuk jemi gjyqtar apo prokurorë ne këtu, ndërsa nëse ju pajtoni me gjitha këto pagesa që unë i ceka mund të dilni në foltore dhe t'ju thoni qytetarëve që pajtoni, por konsideroj se nuk mund ta deklaroni këtë kurse unë qëndroj prapa fjalës time.

Shkarkimi i organeve vendimmarrëse nga kushdo qoftë dhe nga cili do subjekt qoftë, aty ka vetëm qyqarllëk institucional dhe njeri të ligë moral e politik që nuk guxon të jap nënshkrim askund qoftë ai gjyqtar apo prokuror, qoftë politikan apo zyrtar komunal, çështje të cilën nuk mund çdokush dhe për ata edhe jemi në këtë gjendje, prandaj edhe njëherë i drejtohem parafolësit që nëse mundet, të del dhe t'i arsyetoj pagesat dhe ato gjëra që i ceka, por qytetarët nuk janë në dijeni çfarë ndodh këtu sepse nëse një video qarkullon nëpër rrjete sociale, në televizion, ngritët në Kuvend e dinë mediat dhe nuk ndërmer askush asgjë, edhe qytetarët ta mbajnë këtë gjendje kjo nuk guxon të ndodh në askund tjetër përveç në Kosovë, e ai që është në pushtet duhet të ketë përgjegjësi dhe do ta ndjekim hap pas hapi deri në pafundësi, kush do qoftë ai person sepse nuk do të lejojmë të vazhdoj kështu, aq sa mundemi dhe dimë, me forma tona sepse nuk e kemi ndërmend që këtu të veprojmë me forma të dhunshme sepse nuk jemi për ata, por nuk do të lejojmë të ndodhin gjëra të tilla dhe do ta shpalojmë qeverisjen e kujtdo qoftë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, sa i përket ndikimit tim brenda subjektit politik që i takoj dhe kolegëve asamblistë, nuk pres që dikush prej një subjekti tjetër politik të na tregoj neve sa me ndikim jemi në partinë tonë politike, mirëpo unë deshta të jap edhe një vlerësim sepse ndoshta e keni vërejtur edhe nga fjalimet e përparshme të z.Rafet Llapashtica që raporti mes pritshmërive të tij në politikë dhe realitetit duket paska ulët dhe disbalancë, andaj edhe ka sjellje të tilla çfarë jemi edhe duke i parë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dëshiroj të lëshohem në nivel të debatit sa i përket përfaqësimit politik as të individëve që përfaqësojnë një subjekt politik, por po ju tregoj që 80,000.00€ për një tender keni paguar më shtrenjtë të një njeriu që ka ofruar në ofertë.

Po të drejtohem ty zotëri Zymeri edhe pse ti nuk je kompetent, madje vetëm kur del në foltore më bie ndërmend për ty ndërsa asnjëherë tjetër nuk më bie ndërmend përveç që kur ballafaqohemi në këtë Kuvend e që pa qare na duhet të debatojmë. Është sjellë kjo gjendje për qytetarët e që nëse ata dëshirojnë edhe mund ta vazhdojnë këtë qeverisje sepse asnjëherë nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër zgjedhjes së qytetarëve se për këndë vendosin ata dhe i kemi respektuar plotësisht vendimet e qytetarëve qoftë për zgjedhje lokale qoftë për ato nacionale, madje i kemi uruar fituesit, por mos u ankoni rrugëve për gjendjen. Edhe firma juaj Adnan ka marrë pagesa, dhe goxha goxha është (jargit) sjellë para pagesave të kësaj Komune, por duke mos dashur të lëshohem në specifika deri në fund, po ju tregoj se goxha shumë kam të dhëna por që përmbahem të mos përmend dhe të mos jap, mirëpo në situata të tilla, kur dikush tenton ta hedh një hap unë i hedh katër tjerë, madje madje i nxjerrë të gjitha pagesat për kompaninë tuaj zotëri Zymeri, edhe për veprimtarinë politike tuajën, andaj nëse dëshiron ti e mbyllim këtë debat, nëse jo e vazhdojmë sa të dëshironi, madje edhe me ndonjë seancë të jashtëzakonshme.

Nënkryetari i Komunës e potencoj se jemi në fushatë, po e vërtetë që jemi në fushatë por nuk jemi duke diskutuar për kandidat dhe asnjëherë nuk i kam përmend ndonjërin prej kandidatëve, mirëpo

jemi diskutuar për pagesat e bëra sipas këtij raporti e që nuk i ka bërë PDK por i ka bërë dhe sjellë drejtori i subjektit tuaj politik. Prandaj debati mbaron këtu por që keni interesim e vazhdojmë sa të dëshironi, në aspektin institucional e kam fjalën dhe zyrtarisht.

z.Adnan Zymeri, theksoi, sa për sqarim, unë edhe kur kam filluar angazhimin tim politik dhe që kam vendos të merrem aktivisht me politikë e kam ditë që njerëz të cilët nuk kanë kapacitete për të vlerësuar punën time individuale do të lëshohen edhe në gjëra personale dhe do të lidhen edhe me çështjen e kompanisë, e që në realitet është një kompani që funksionon qe 20 vite, pra edhe kur nuk kam qenë asamblist, andaj logjika të tilla, si të parafolësit, që të përjashtohen persona të caktuar prej aktiviteteve individuale për shkak të bizneseve të cilat lidhen me anëtarë të familjes time është logjikë e vjetër. Babi im as nuk është aksionar i asaj kompanie as asgjë tjetër, si dhe unë nuk jam këtu përfaqësues i bizneseve por jam përfaqësues i qytetarëve dhe do të vazhdoj angazhimin tim në këtë drejtim duke u munduar që interesat e qytetarëve t'i vendosë në rend të parë.

Edhe në të kaluarën është përmend emri im e që qëllimisht nuk e kam ndërlidh këtë çështje me replika apo reagime për shkak se nëse e mbrojë një kompani të caktuar atëherë duhet t'i mbrojë edhe gjitha kompanitë tjera që operojnë në Komunën e Podujevës, prandaj unë me këtë sqarim e përfundoj diskutimin tim rreth kësaj çështje.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, unë gjithherë kam dyshuar se raporti financiar nuk na vie i njëjti me kolegët e LDK-së, në bazë të vlerësimeve që i kemi pas. Këshilltari parafolës kolegu z.Avni Fetahu u mundua t'i përfshijë të gjitha, mirëpo kanë mbetur edhe disa shuma të vogla të cilat nuk u cekën nga askush por që mua mu kanë dukur shumë të çuditshme, shembull, furnizim me dokumente bllanko që ka një shumë 8,895.00€ prandaj a mund të na tregoni se çfarë është kjo pagesë dhe çfarë janë këtë dokumente bllanko, pastaj për mirëmbajtje rutinore nga 2,790.00€ sa kanë qenë në vitin 2019 tani në vitin 2020 është 29,247.00€ andaj a mund të na informoni për çfarë mirëmbajtje rutinore bëhet fjalë. Gjithashtu për dallim nga viti 2019 që ishte 245 € që kanë qenë për reklama dhe konkurse tani në vitin 2020 kemi një ngritje në shumë 4,111.00€ a do të thotë kjo se e keni shfrytëzuar buxhetin e Komunës për të shtypur për partinë.

Po ashtu kur u diskutua për dru për ngrohje e u tha se janë eliminuar operatorë ekonomik sa i përket furnizimit për ngrohej qendrore, ka rritje të shpenzimeve në këtë vit, përkatësisht në vitin 2019 kanë qenë 51,174.00€ ndërsa tani në vitin 2020 janë 102,544.00€, pra pse duhet të ketë rritje aq të madhe për dru. Mos të harrojmë se në këtë raport financiar shembull kemi edhe tenderë, e që unë i them edhe kolegut z.Adnan Zymeri meqë ai filloj aq shumë ta mbroj LDK-në, siç është ai për furnizim të ujitjes pikë-pikë si dhe pajisje tjera për kultivimin e mjedrës dhe specit ku janë eliminuar operator ekonomik shumë më të lirë sepse janë kërkuar ISO standardet, e që unë këtu e kam edhe dokumentin sipas të cilit në konkurs janë kërkuar këto ISO standarde që nuk lidhen aspak me ata që janë shpallur kurse janë eliminuar operator më të lirë ekonomik vetëm për t'ia jap kompanisë së tyre më të shtrenjtë që ta fitoj tenderin.

z.Gëzim Namani, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime për këshilltarin z.Avni Fetahu rreth atyre çka u than, sa i përket digjitalizimit të sallës së Kuvendit kjo çështje është në procedurë e sipër dhe ende nuk ka përfunduar kështu që ju nuk keni mund të votoni, pra fjala është për sallën e re të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës e që është në proces të tenderimit.

Sa i përket asaj që e potencuat kinse menaxheri i kontratës ka thënë hjeke gypin, ju bëj me dije se menaxheri i kontratës nuk mund ta bënë një gjë të tillë sepse nuk mund ta dinë paraprakisht se cila kompani do të shpallet fituese ndërsa menaxheri caktohet me rastin e nënshkrimit të kontratës dhe pastaj vazhdon me mbikëqyrje.

Çështja tjetër, për rastin e menaxherit të prokurimit, jo vetëm në këtë seancë, por vazhdimisht po flitet e po flitet për menaxherin e prokurimit, madje po flitet sikurse ne të jemi një Gjykatë, a jeni në

dijeni rreth prezumimit të pafajësisë, madje po ju qeshet por për këtë çështje mund ta pyesni edhe kolegun z.Bajram Ajetin i cili është jurist me profesion, pra rasti është pran organeve kompetente, andaj nuk është mirë që ne të diskutojmë rreth atij rasti përderisa është në procedurë por të shohim verdiktet e prokurorisë dhe të gjykatës dhe nëse i njëjti del fajtorë atëherë janë procedurat administrative të cilat duhet të zbatohet konform vendimit të gjykatës, kështu që në këtë drejtim ju bëjë thirrje të mos tentohet t'i bëhet presion të llojit të vetë gjykatës duke përmendur vazhdimisht menaxherin e prokurimit, e keni dorëzuar një kallëzim penal andaj t'i presim rezultatet. Jemi në dijeni se sipas Ligjit të ri për zyrtarët publik nëse dënohet mbi tre muaj, duhet të largohet nga puna e që besoj se në raste të tilla do të marrim masa të tilla sipas ligjit, andaj deri në vendimin përfundimtar të gjykatës ju lus të gjithëve që të mos bëhet presion i panevojshëm por të thirremi në prezumimin e pafajësisë deri sa organet kompetente ta thonë fjalën e tyre.

z.Avni Fetahu, theksoi, një fakt është interesant se të kuptuarit dhe artikulimi i fjalive janë edhe element qenësor gjatë diskutimit publik sidomos me qytetarë, mbase këto e dallojnë njeriun nga frymorët e tjerë që ekzistojnë në këtë botë, por sido që të jetë unë e kuptoj që ti (i drejtohet drejtorit parafolës Gëzim Namani) nuk dinë asgjë në këtë punë dhe ky naivitet i juaji më bënë të çuditem me faktin ku prej momentit që ke ardh si drejtor i Drejtorisë së Administratës tu kanë kryer pagesa për komunën e re pa pasur mall fare, kështu që ti nuk i merr vesh hiq këto punë por vetëm dole në foltore sa për të thënë diçka palidhje. Menaxherët e projekteve i hartojnë specifikat më herët, të nisura me koordinim të drejtorit përkatës, e që harrova të potencoj edhe një element sepse as drejtorët nuk janë pa behane sepse nga aty niset dhe kurdiset tenderi, te specifikat, menaxheri i tenderit dihet kënd e cakton pastaj dhe krejt këta pazaret i bëjnë, dhe tani me fillu e me dal në foltore dikush me mbrojtur një menaxher të prokurimit një “tuxhar” tenderësh unë po çuditem prej anës tuaj drejtor e para, kurse e dyta aty është një video incizim i kuartë që pasqyron qartë pazarin që është duke u realizuar aty dhe ju si Komunë dhe Nënkryetari i Komunës nuk keni marrë asnjë masë disiplinore ndaj tij, kurse arsyeja e mos marrjes së masave është çështje e kuartë sepse ju kemi thënë se ai është “kukëll”, ai që e ka vendos menaxher të prokurimit atë, e që tani është Ministër është kah i vyen ende me qenë aty, me vjedh bashkë, kështu që të jemi të kuartë për këtë punë.

Kryesuesi i Kuvendit, ju tërheq vërejtjen këshilltarëve që të jenë më të kujdesshëm sa i përket fjalorit dhe shprehjeve.

z.Gëzim Namani, i drejtohet parafolësit, theksoi, sinqerisht më vie keq që për 8 vite të jesh drejtor dhe të mos arrish t'i kuptosh ende procedurat është goxha e rëndë.

Nuk jam duke e mbrojtur askënd këtu, po e mbroj parimin prezumimi i pafajësisë nëse veç e kupton çka është, nëse jo ju lutem ta pyesni juristin e juaj ju tregon. Edhe njëherë nuk u mundova ta mbrojtë individin por po e mbroj parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e ligjshmërisë, madje edhe nëse dëshiron të ndërmarrësh diçka nuk mundesh sepse kemi të bëjmë me një rast që t'i personalisht e ke dorëzuar në gjykatë, andaj pritni deri në një vendim të Gjykatës dhe në momentin që ka një vendim nga Gjykata ne këtu pari jemi.

z.Bajram Ajeti, theksoi, një gjë duhet ta kemi të qartë se çka janë parimet, çka janë procedurat dhe çka është ligji, ajo që drejtori parafolës e thotë është parim i përgjithshëm universal në sistemin juridik apo sistemin anglo-sakson të cilit i takojmë edhe ne, por megjithatë në këtë rast të zotëri Fejzës, të cilin më vie keq që po e përmendi sepse e kam pasë vartës pas luftës së departamentin për zhvillim rajonal fshatra dhe ambient, por ja që njerëzit kur bijën nën ndikim si duket të leverdive apo interesave të dikujt dhe që ja e humb pastaj edhe moralin edhe dinjitetin sepse bie në nivel të tillë që realisht ka elemente të veprës penale.

Për të sqaruar më qartë, zyrtar publik, por mos harroni se edhe nëse është në fuqi në tërësi Ligji për zyrtarët publik, në kuadër të kësaj e ka edhe shërbimin civil dhe jam i bindur se e dini shumë mirë që

nëpunësi civil i nënshtrohet edhe Kodit të Mirësjelljes për shërbimin civil por edhe Ligjit për shërbimin civil, dhe zyrtari i prokurimit është nëpunës civil e që në rast se një nëpunës civil bie ndesh me Kodin e Mirësjelljes për nëpunësit civil apo edhe me Ligjin përkatës atëherë ai nëpunës sipas Ligjit duhet të pezullohet nga puna me njohjen apo me marrjen e informatave se dyshohet se ka shkel Kodin apo Ligjin, ndërsa këtu është gjithçka e qartë që ai zyrtar ka shkel edhe Kodin e Mirësjelljes edhe Ligjin dhe si rrjedhojë është iniciuar hetimi penal, mirëpo institucioni të cilit i takon zyrtari është i obliguar të inicioj procedim disiplinor, suspendim parandalues të paktën për një afat 3 muaj.

Kryesuesi i Kuvendit, tërheq vërejtjen që të kaloj në temën për çka jemi duke diskutuar sipas rendit të ditës e jo të mbahen ligjërata jashtë pikës përkatëse, ose në të kundërtën thekson se do të detyrohem t’ia ndërpres fjalën, kushdo qoftë ai.

z.Bajram Ajeti, vazhdon, kështu që e keni gabim dhe që për mos marrje të masave nuk është rasti i parë sepse keni edhe rastin e Ahmet Ahmetit për të cilin jeni në dijeni shumë mirë që ai nuk ka zbatuar vendimet gjyqësore, Gjykata e ka shpallë fajtor dhe ju as që jeni marrë me procedura disiplinore, as që keni iniciuar procedura disiplinore, e keni dëmtuar buxhetin për 10,000.00€ e që për këtë gjë e keni pasë për obligim që të ndërmerri edhe procedura disiplinore, por që edhe për këtë është kallëzimi penal, si duket do të pasojnë edhe kallëzime tjera penale, por ndoshta edhe kthjelllet moti dhe secili të jap përgjegjësi për atë që ka bërë, vetëm për veprimet apo mos veprimet që janë bërë në kundërshtim me Ligjin apo kodin e Mirësjelljes.

z.Agim Blakqori, drejtor i DKA, theksoi, në kuadër të programit fitues të zgjedhjeve 2017/2021 ka qenë edhe projekti për ndërtimin e shkollës “Elfir Behrami” në fshatin Metehi e cila afërsisht që 1 vit ka filluar dhe tani pothuajse është e gatshme dhe vetëm presim inventarin nga Ministria e Arsimit që ky projekt të përfundoj. Ju ftoj ta vizitoni sepse unë hiq më larg se një ditë më parë e kam vizituar dhe vërtetë është kënaqësi të shohësh.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, e ndjejë të nevojshme të jap vetëm një sqarim sepse është për herë të parë shprehet një shqetësim për një kod ekonomik ku thuhet dokumente bllanko andaj edhe e ndjeva të nevojshme që ndokush të mos ketë dilema nga e vërteta se për çfarë bëhet fjalë.

Lidhur me këtë është bërë furnizim me dokumente të gjendjes civile që i përkasin shërbimit të Ofiqarisë e që të gjitha ato dokumente që lëshohen nga shërbimi i cekur i përkasin këtij kodi ekonomik me emrin dokumente bllanko i cili pastaj përpunohet në ofiqari dhe lëshohet si dokument zyrtar.

Pra vetëm këtë kisha sepse vërtetë është për tu sqaruar sepse emërtimi si dokumente bllanko paksa mund të ketë keqkuptime nga ndokush.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës sipas rendit të ditës.

5. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për Komunën e Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019

➤ Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, gjatë periudhës së parë të vitit 2020 Komuna e Podujevës e ka audituar një ekip i Zyrës Kombëtare të Auditimit i cili ka pasur për qëllim auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Podujevës të përfunduar më 31.12.2019 dhe që ka përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet që kryhen në Komunën e Podujevës dhe bashkëpunimi ynë me ta ka qenë korrekt dhe për

të gjitha çështjet që kanë qenë objekt i auditimit i'u ka ofruar një bashkëpunim për çka edhe jemi vlerësuar nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Auditimi ka qenë i fokusuar tek pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe rekomandimet e viti të kaluar dhe viteve të mëparshme. Opinionet e auditimit mund të jenë të ndryshme varësisht nga të gjeturat por çdo herë të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit e të cilat janë: mohim opinionit, opinion i kundërt, opinion i modifikuar dhe opinion i pa modifikuar, sqarimet në secilën nga këto opinione auditori i jep në faqet 32 deri 34 (shtojca 1).

Siç e keni parë të gjithë në raport që janë shpërndarë në materialet e juaja dhe opinionit për Komunën e Podujevës është opinion i modifikuar, sipas opinionit Zyra Kombëtare e Auditimit, pasqyrat vjetore financiare prezantojnë pamje të drejtë, të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe buxhetit të realizuar të Komunës së Podujevës për periudhën e përfunduar më 31.12.2019 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për shërbimet publike-kontabilitet i parasë së gatshme.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregulloret Financiare të Ministrisë së Financave për Pasqyrat Vjetore Financiare, natyrisht një opinion i modifikuar jepet atëherë kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që janë: kur pasqyrat vjetore financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar për bazë edhe politika të pranuar të kontabilitetit e që janë zotuar në një mënyrë konsistente përgjegjësisht të qëndrueshme, pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante, pamja e paraqitur në pasqyrat vjetore financiare janë në përputhje me njohurit e auditorit në lidhje me etnitetin e audituar. Pasqyrat paraqesin një shpalosje adekuate në të gjitha çështjet materiale relevante për pasqyrat financiare. Konkluzion i përgjithshëm i auditorit mbi qeverisjen është: Kontrollat e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha mirëpo janë vërejtur disa dobësi tek disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë shpenzimet, të hyrat, pasurit dhe llogaritë e arkëtueshme. Më tutje planifikimi dhe realizimi i buxhetit tek projektet kapitale është realizuar vetëm 69% sipas tabelave të cilat janë edhe në raportin e auditorit. Sa i përket realizimit të buxhetit kapital mendoj se është një trajtim jo i drejtë nga ana e auditorit për shkak se në këtë përqindje ka ndikuar llogaritja e kredisë së bankës së Austrisë për kolektorin e ujërave të zeza, projekt që ka filluar në tetor dhe nuk ka mundur të ketë progres më të lartë e në këtë e kemi diskutuar si çështje edhe me auditorin që kjo të veçohet por nuk kemi hasur në mirëkuptim, mirëpo është me rëndësi se grandit është shfrytëzuar 96% kurse fondet tjera të pa shfrytëzuara barten në vitin tjetër, rekomandimet e vitit paraprak konstatim i auditorit është se nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmasimin e organizatës, mirëpo kur jemi te rekomandimet për vitin 2018 ku ishin 20 rekomandime, 10 prej tyre janë zbatuar në tërësi ose 50% e që është për tu vlerësuar, vetëm 3 nuk janë adresuar 6 janë të mbyllura. Kurse në raportin e vitit 2019 është zvogëluar numri i rekomandimeve nga 20 në 15. Angazhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, angazhimin, rrezikun dhe raportimin menaxherial thuhet duhet të forcohet konstatim i auditorit. Lidhur me vërejtjet, gjegjësisht çështjet që ata i kanë ngritur kanë dhënë rekomandime në mënyrë që kryetari së bashku me stafin e tij të ndërmarrin veprimet e duhura që këto çështje në të ardhmen mos të përsëriten, andaj duke u bazuar në këtë çështje ne kemi përgatitur një raport - plan veprimi lidhur me veprimet e kërkuara nga secili rekomandim në mënyrë që vërejtjet e njëjta mundësisht të mos përsëriten edhe në raportet tjera. Plani i veprimit i është përcjell ZKA-së dhe është pjesë përbërëse e materialit për këtë diskutim. Po e përmbyllë me fjalën time me konstatimin se nëse Komuna e Podujevës merr opinion të pa modifikuar atëherë tatim pagesit mund të jenë të kënaqur sepse taksat e tyre po përdorën në mënyrë korrekte.

z.Vendenis Lahu, theksoi, fillimisht me lejoni të ju urojë për ardhjen e raportit të auditorit, sepse ka 3 apo 4 muaj që është dashur të sillet në Kuvend për diskutim, por nuk ka ardhur deri më sot, besoj që mos të themi e fundit jemi ndër komunat të pakta të cilat ende nuk është diskutuar raporti i auditorit, ky raport i auditorit i cili është sjell paraqet një nga vërejtjet të cilat ne i kemi adresuar në adresë të qeverisjes komunale gjatë tërë kohës dhe me të cilat ankesa vërejtje dhe kritika ajo nuk është përmirësuar asnjëherë deri me tash. Në terma të përgjithshëm raporti shpërfaq mangësi të qeverisjes komunale prej planifikimit e realizimit të buxhetit, klasifikimit jo të rregullt të shpenzimeve, të hyrave vetanake, pasurive kapitale e deri te investimet shumë të nevojshëm në Komunën e Podujevës. Tek investimet kapitale ashtu siç kemi paralajmëruar gjatë tërë vitit 2019 në mungesë të planifikimeve të mirëfillta gjatë tërë vitit buxheti për investime kapitale është realizuar vetëm në masë prej 69% dhe nga kjo shumë 90% e saj është realizuar në 2 mujorin e fundit, ky keq planifikim i shpenzimeve të bënë të mendosh se shumë nga projektet iniciohen edhe nga operatorët e ndryshëm varësisht nga nevojat e tyre, përveç përdorimit për qëllime elektorale të buxhetit siç ka qenë rasti vitin e kaluar.

Gjetje tjetër e auditorit janë edhe klasifikimi i gabuar i shpenzimeve, në këtë kategori auditori ka evidentuar një ekzekutim të pagesës në vlerë prej 33,558.00€, auditori trajton këtë çështje nga aspekti formal ekonomik por është e rëndësishme të shpjegohet pse ka ndodhur kjo, bëhet fjalë për një punëtoare të arsimit e cila është larguar pa të drejtë nga procesi arsimor andaj ky rast përveç dëmit financiar të madh siç shihet të cilin ia ka shkaktuar Komunës së Podujevës tregon edhe mentalitetin e kësaj qeverisje të përzgjedhjes mbi baza partiake të rekruteve edhe pse rasti në fjalë shkon përtej përzgjedhjes në baza partiake mund ta klasifikojmë edhe si përndjekje, këta janë mekanizma kompensator për mbajtjen e pushtetit në mungesë të ideve, dëshirës, punës së planifikimit por është lajm i mirë për qytetaret që këta mekanizma kompensator po shkojnë drejtë dekompenzimi të plotë. Tek kategoria e pagave dhe mëditjeve auditori ashtu siç kemi potencuar shumë herë ka gjetur një numër të madh të të punësuarave për shërbime të veçanta, madje ka pasur një numër të madh të të punësuarve me kontrata mbi vepra edhe për pozicione të rregullta të punës, kujtojmë këtu rastin e 8 infermierëve që punojnë me kontrata mbi vepër që 7 apo 8 vite. Tek subvencionet dhe transferet ashtu siç u përmend edhe me herët nga disa nga koleget e mi nuk kemi kurrfarë plani të subvencionimit të OJQ-ve. Shoqëria civile dhe OJQ-të e mirëfillta janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e funksionimin sa më të mirë të jetës publike në Komunën e Podujevës. Në mungesë të përkrahjes për kategoritë e tilla kemi një numër enorm të OJQ-ve mbi 200 sosh, fiktive shumica sigurisht por shumë pak OJQ të mirëfillta të cilat interesin qytetarë e kanë prioritet, edhe pse në Komunën e Podujevës ka OJQ të mirëfillta por të cilat nuk janë të varura nga Komuna e Podujevës. Eliminimi i operatoreve ekonomik, në këtë kategori auditori ka gjetur se Komuna ka kontraktuar operatorin ekonomik që kishte ofertën në vlerë 331,177.00€, dhe kishte eliminuar operatorin ekonomik me ofertë më të lirë, pra ofertë prej 255,447.00€, duke shkelur kështu Ligjin mbi prokurimin publik, por kjo formë e shkeljeve tek operatorët ekonomik në eliminimin e këtyre tenderëve nuk është e vetmja formë sepse kemi pasur raste siç e cekam edhe me herët të shkollës “Elfir Behrami” në Metehi ku Komuna ka përzgjedhur operator ekonomik më të lirë pastaj ka akorduar shumë tjetër parash, pra shumë shtesë në emër të punimeve shtesë gjë e cila e ka rritur vlerën e shpenzimeve për projektin në fjalë përtej asaj fillestare në emër të së cilës edhe e kishte fituar tenderin si ofertë më e lirë, trik i komunës ky për ta favorizuar operatorin e preferuar. Kur bëhet fjalë te favorizimi i operatorëve të preferuar që në këtë rast nuk i është dhënë tenderi ofertës me të ultë përveç që është shkelje e Ligjit mbi prokurimin publik është edhe konflikt interesi sepse operatori i preferuar i komunës kur e fiton tenderin atëherë edhe qasja ndaj tij është pak më e butë dhe munden edhe të mos shkojnë ashtu siç kanë planifikuar dhe menduar komuna.

Gjetje tjetër kemi tejkalimet e kontratave kornizë të zakonshme këto në Komunën e Podujevës në mungesë të planifikimit të mirëfilltë. Vërejtje tjetër që përsëritet vazhdimisht në çdo raport është po ashtu taksës komunale, Komuna asnjëherë nuk arkëton taksën komunale nga bizneset dhe në të njëjtën kohë e lë në fuqi atë duke u bërë kështu nga Komunitat e pakta për të mos thënë e vetmja me këtë taksë në fuqi edhe ky është një mekanizëm presioni ndaj bizneseve të vogla kur dihet se mbledhja e kësaj takse të grumbulluar për vite me radhë e kërcënon me shuarjen e bizneseve të vogla e të cilët në Komunën e Podujevës janë të shumtë. Këto dhe shumë vërejtje tjera janë duke u përsëritur vit pas viti ka edhe shumë vërejtje tjera në raportin e auditorit të cilat unë nuk i kam cekur por besoj që do ti cekin koleget e mi. Ka po ashtu vërejtje të cilat përsëriten vazhdimisht ndaj këto dështime, ky keq menaxhim që po i dëmton interesat shoqërore në vazhdimësi duhet të merr fund sa më parë aq më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, tani nëse më lejoni e ftoj këshilltarin më të vjetër në moshë për të më zëvendësuar për pak minuta.

z.Mehmet Gashi, merr kryesimin e Kuvendit në cilësinë e këshilltarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot po diskutojmë për raportin e auditimit për vitin 2019 që është fokusuar në 3 pika, në pasqyrat financiare vjetore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe në zbatimin e rekomandimeve që janë obligim nga ky raport. Referuar këtij raporti të auditorit me të drejtë mund të konstatojmë se pasqyrat financiare vjetore janë të përgatitura në pajtim me Rregulloren e Ministrisë së Financave nr.01/2017 për raportin vjetor financiar për çdo organizate buxhetore, pastaj kontrollat mbi të hyrat dhe shpenzimet janë të përshtatshme por gjithmonë ka hapësirë për përmirësim në secilin sektor në respektimin e rregullave apo legjislacionit në fuqi. Gjithashtu ekzekutivi është treguar efikas dhe në zbatimin e rekomandimeve që obligon ky raport i auditorit gjeneral dhe pikërisht për këto arsye që unë i ceka më herët është nxjerr edhe opinion i pa modifikuar i këtij raporti tregon se Komuna e Podujevës si organizatë buxhetore ka arritur me të drejtë të ketë një menaxhim të drejtë të përgatitur në të gjitha aspektet materiale.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne si subjekt politik i kemi hasur të gjitha të gjeturat e auditorit për periudhën e përfunduar për vitin 2019, për të mos e zgjatur shumë do i 'u shkojë me radhë disa nga pikat ku kam vërejtur se ka shkelje të ligjit do ti cek ato dhe në fund të gjitha këto janë pranuar nga Nënkryetari i Komunës së Podujevës z.Nexhmi Rudari me një shkresë ku do t'ua paraqes para juve. Keq klasifikimi i shpenzimeve: dy pagesa ishin ekzekutuar nga thesari në kategori të gabuar në vlerë prej 33,508.00€ ku këto pagesa janë bërë për shkak të një punëtorie e cila është larguar jashtëligjshëm nga arsimit dhe përveç demit material që është shkaktuar unë besoj këtu ka edhe një dëm moral që shkaktohet ndaj saj dhe ky është i pa riparueshëm.

Mangësi tek kontratat për shërbime të veçanta ku Komuna e Podujevës kishte angazhuar 30 persona me kontratë për punë dhe detyra të specifikuara ku 23 prej tyre punonin për periudhë kohore me të gjatë se 4 muaj brenda këtij viti në këtë mënyrë komuna kishte angazhuar 9 persona përmes marrëveshjes për shërbime të veçanta për të cilët nuk kishte zbatuar një procedurë të thjeshtëzuar të rekrutimit. Subvencionet dhe transferet: mungesa e planit të subvencionimit të OJQ-ve ku edhe kjo u cek më herët. Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit ku edhe këtu kemi shkelje tek kjo çështje. Hartimi i specifikave teknike duke përdorur emra tregtar edhe kjo është një çështje që ka shkelje të ligjit. Eliminimi i operatorëve ekonomik me ofertë më të lirë, do të thotë që komuna eliminon operator për 75,000.00€ me çmim më të lirë dhe favorizon ata që janë me çmim më të lartë. Pagesat, avancet në kundërshtim me Ligjin e buxhetit edhe këtu kemi shkelje të ligjit. Tejkalimi i kontratës kornize edhe këtu unë nuk e di se në fund e kemi një shkresë e cila i është dërguar raportit të auditorit nga Nënkryetari i Komunës së Podujevës z.Nexhmi Rudari ku i pranohet të gjitha këto të

meta dhe unë nuk e di se në Komunën e Podujevës a ekzistojnë Ligjet e Republikës së Kosovës apo këta punojnë me ndonjë ligj tjetër. Ne si subjekt kërkojmë hetime nga prokurori i shtetit për zyrën e prokurimit në Komunën e Podujevës. Ose të më tregojnë se janë duke punuar me ndonjë ligj të veçantë.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, kur flasim për auditim dua të them që raportin e auditimit e kuptoj apo auditimi është vlerësim raport i asaj që është kundrejt asaj që do duhej të ishte apo që do duhej të jete, ku jemi ne dhe ku është Komuna e Podujevës me këtë, konstatimet, të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit tani të specifikuara dhe të publikuara në raportin e auditorit për Komunën e Podujevës për çdo grupim apo individ të interesuar si dhe për të gjitha organet kompetente që do i ‘u shërbej qoftë për informim, konsultim, debat apo hetim. Ne sot e kemi në Kuvend për të debatuar këtë raport dhe kështu na është përcaktuar ligjërisht, të gjeturat, konstatimet e paraqitura në këtë raport pjesërisht janë të njohura për ne të paraqitura në raport qoftë periodike, qoftë si tersi raporti financiar 2019, kuptohet raporti i auditimit të jashtëm ka kompetence, profesionalizëm, pavarësi, dhe si e tillë ka peshën në konstatimet dhe rekomandimet e tij, shpalos devijimet nga standardet, shkeljen e parimeve të mirëqeverisjes deri te shkeljet ligjore në menaxhimin e financave publike, paraqet dhe konstaton sa është e menaxhuar komform rregullave dhe standardeve më të avancuara të menaxhmenteve, nga të gjeturat deri në sipërfaqe efikasiteti, efektiviteti, ekonomizimi apo nikoqirllëku i menaxhimit të buxhetit dhe rekomandon ndërmarrjen e masave për përmirësim, ngarkon me ndjenjën e përgjegjësisë ata të cilët janë përgjegjës në llogaridhënie, të ndërmarr masa parandaluese për devijimet e mundshme dhe të bëjë përmirësimin e tyre, këtu u debatua për dhe kundër u cilësua mire dhe jo mire sa që të krijohet përshtypja që janë dy raporte fundja dhe ashtu mund të akceptohet varësisht prej cilës pik projektuese e lexon, jam e mendimit me ata që kritikuan dhe kisha dashur të jem me më pak rekomandime për përmirësime, kisha dashur që të kishim përqindje tjetër të shpenzimeve të buxhetit sepse kemi nevoja dhe kërkesa nga qytetarët si në ambient, infrastrukturë, arsim, shëndetësi, mirëqenie dhe standarde më të larta të shërbimeve komunale. Për vite më radhe suficienci deri në 4 milion shumë a jo shumë nuk dua të kthehem në të mirat që kishin dhe mund të kthehen të qytetari, kisha dashur të mos kemi defekte lëshime të numëruara ose të minimizojmë sa më shumë, por jam me ata që po e mbrojnë si gjithçka, është në rregull dhe duhet ta pranoj se ka mundur të jetë edhe më keq, ngase e keqja nuk ka fund ashtu si edhe e kundërta e saj e mira. Kështu që fjalimin tim po e përfundoj me dy thënie: “Kush punon gabon”, dhe “E keqja nuk qëndron tek gabimi i kryer por tek justifikimet që kërkon ta mbulosh”. **z.Avni Fetahu**, theksoi, u paraqiten diskutime dhe çështje shumë të rëndësishme lidhur me raportin e auditimit, nga z.Vendenis Lahu dhe të tjerët, unë kam disa pyetje konkrete për ata që e vlerësojnë që mund të japin përgjigje, kushdo që ka mbet nga Ekzekutivi këtu në sallë.

Pse është përjashtuar nga ky raport i auditimit çështja e kolektorit të ujërave të zeza, projekt i cili e dini që i ka kushtuar dhe po i kushton Komunës së Podujevës 5,300.000.00€ dhe për këtë projekt Komuna e Podujevës dhe qytetarët e saj të paktën për 19 vite kanë për ta paguar këtë kredi, ne e kemi kërkuar një ofertë financiare ku pasqyrohet paralogjaria dhe paramasa për këtë projekt por që nuk është sjell, është dërguar një material në gjuhën angleze të cilën e kemi përkthyer, ku thuhet marrëveshje bilaterale në mes komunave.

Pastaj kam edhe një pyetje tjetër tek pika e auditorit të jashtëm ku është shuma prej 75,730.00€ e që është kontraktuar një kompani më e shtrenjtë, po ju drejtohem juve drejtores cilido që e ka pasur këtë projekt, a keni marr ndonjë masë për këto shkelje ligjore apo ndonjë masë disiplinore, nëse nuk keni marr atëherë kjo tregon se këtu është një grup i strukturuar kriminal dhe jeni duke bashkëpunuar në mes vete, nëse keni ndërmarr atëherë tregoni, përndryshe edhe pse drejtori i Drejtorisë përkatëse iku nga kjo sallë, por që edhe po i tregojmë se ky fjalor ligjor për qeverisjen ligjore, të cilin na e

kanë dhënë Asociacioni i Komunave të Kosovës tregon edhe çka përbenë vepra penale në detyrë zyrtare, janë 15 pika gjithsej ku në 10 prej tyre e gjeni z.Rasim Fejzën në kuptimin e publikimit të videos së tij, në cilëndo që ndalesh është abuzim i pozitës apo autoritetit zyrtar, abuzim apo mashtrim i prokurimit publik, shpronësim i detyrës, mashtrim në detyrë, tregtim me ndikim, kudo që shikohet videoja e publikuar, del në këto pika. Kështu që nuk e di se çka ke për të ndërmarr tjetër, ne nuk po i përzihemi gjyqësisë por është dashur që komuna ta ndërmarrë ndonjë masë përmes komisionit disiplinor ndaj atij rastit e jo ti shkarkoj drejtorët e që keni pasur një drejtor ekspert për të gjitha fushat që ka qenë z.Hamdi Jaha edhe atë e keni shkarkuar në vend se me zgjedh çështjen e z.Rasim Fejza.

znj.Endritë Murati, theksoi, raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës, edhe këtë vit del të jetë brenda trendit tërësisht negativ që e ka përcjellë komunën edhe nga vitet e kaluara. Refuzimi për të krijuar një sistem të brendshëm llogaridhënës të menaxhimit të burimeve e resurseve financiare të Komunës flet për mungesë totale të vullnetit për të menaxhuar drejt me pasuritë e komunës. Me fjalë të tjera, parregullsitë që i kemi parë e lexuar edhe këtë vit në këtë raport, për shkak se janë të përsëritura dhe qartazi janë lejuar nga kreu i Ekzekutivit të Komunës.

Nuk mund të ketë shpjegim tjetër për një gjë të tillë kur shihet qartë që natyra e shkeljeve të ligjit e veprimeve abuzive veç sa shkon duke u thelluar. Nuk është absolutisht e rëndësishme që, për këto çështje të evidentuara në Raportin në fjalë, Komuna përgjigjet shpesh në stilin se “I kemi zbatuar disa rekomandime nga raporti i një viti më parë”, kur dihet se për çdo vit, gjetjet, si për nga numri e si për nga natyra e shkeljeve janë gjithnjë në trend të përkeqësimit në raport me numrin e zbatimit të rekomandimeve. Mungesa e zbatimit të dispozitave ndëshkuese disiplinore për zyrtarët që kryejnë shkelje, mungesa e vullnetit nga ana e organeve të ndjekjes penale për të hetuar akuzuar e gjykuar dëmet financiare në pothuajse shumicën e kategorive dhe programeve po inkurajon papërgjegjësinë në menaxhimin e financave në Komunën e Podujevës.

Në raportin e auditimit i kemi pothuajse të gjitha natyrat e shkeljeve dhe keq menaxhimit, duke filluar nga keq klasifikimi ku shpenzimet kontigjente nuk planifikohen siç duhet dhe kështu, nga veprimet jo ligjore të Komunës të dëshmuara me vendime të Gjykatave, e pëson buxheti i projekteve kapitale për pagesën e kompensimeve në paga, pastaj të dobësisë në planifikimin e rregullt të buxhetit në kategorinë “paga dhe mëditje” dhe ku për pasojë paguhen paga jubilarë nga kategoria e “mallrave dhe shpenzimeve”.

Shkeljet e ligjit vijnë edhe në planifikimin dhe administrimin e burimeve njerëzore përgjatë vitit fiskal. Mbahen në punë punonjës me detyra të rregullta ndërkohë procedurat e angazhimit të tyre janë për detyra specifike. Tejkalohe afatet ligjore për vazhdimin e kohës së angazhimit të këtyre punonjësve dhe po ashtu nuk zhvillohen fare procedurat e thjeshtëzuara për të angazhuar përmes kontratave të ashtuquajtura Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Kështu që Komuna, shërbimet publike i përkthen në dhurata për “të preferuarit e tyre”.

Në faqe 12 të raportit, Zyra Kombëtare e Auditorit, lë të kuptohet se në përgjigjet që i ka dhënë Komuna përkritazi me gjetjet, Komuna ka tentuar të vë në lajthitje zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditorit. Kjo vërehet qartë në pjesën ku flitet se si Komuna ka angazhuar punonjës që kryejnë shërbime të rregullta përmes procedurave që angazhohen punonjës me detyra specifike, ku thuhet citoj: Këto pozita konsiderohen si pozita të rregullta të punës e jo si detyra specifike siç janë cilësuar nga ana e Komunës. Sipas Komunës kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit, mirëpo Komuna ka pasur të aprovuar me ligjin e buxhetit 1980 pozita, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarave ishte 1921 në pasqyra vjetore të Komunës. Pra në një anë thuhet se kemi pasur mungesë të pozitave të aprovuara, e në anën tjetër, kanë qenë 59 pozita të lira të buxhetuara më shumë se sa numri total i verifikuar nga ZKA.

Procedurat e prokurimit dhe lidhja e kontratave pa projektet zbatuese është, përveç se e kundërligjshme dhe qartazi me potencial të lartë për abuzim, në të njëjtën kohë projektet e tilla rrezikojnë edhe minimumin e mundshëm të cilësisë së projekteve për të cilat shpesh qytetarët dhe ne çuditemi se si pas disa javësh që përurohen projekte, nisë degradimi i tyre.

Sipas shumë raporteve kredibile ndërkombëtare, kur flitet për standardet e prokurimit publik, shkeljet e ligjit në fuqi duke përdorur specifikime teknike që kanë shenja dalluese apo lloj të veçantë që nuk lidhet me funksionin por me vendin e origjinës, janë tipike raste me elemente të kurdishjes së tenderëve dhe shoqërohen me korrupsion. Një gjë e tillë, përgjithësisht, nuk ndodhë rastësisht, aq më pak në projekte me vlera të mëdha.

Referenca në dispozitat e caktuara ligjore duke shpërfillur zbatimin e tyre mbi parimin e të vërtetës materiale por duke i keq cituar sipas parimit të së vërtetës formale, na përsëritet edhe tek rasti i gjetjes apo çështjes A5 në raport, përkitazi me çmimin jo normalisht të ulët.

Çmimi jo normalisht i ulët është një dispozitë përjashtuese nga rregulli, e cila, në asnjë rast nuk guxon të aplikohet në mënyrë arbitrare dhe pa verifikim faktik. Asnjë autoritetit kontraktues nuk i lindë e drejta automatikisht për ta eliminuar një operator në rastin e parë kur dyshohet se çmimi është jo normalisht i ulët. Vlerësimi nëse duhet të refuzohet ose jo një operator në situatë të tillë duhet të jepet vetëm pasi të merren në shqyrtim dhe analizë dëshmitë e shkruara dhe të pakontestueshme se operatori është apo jo prodhues i materialit apo shërbimit të caktuar, apo se për shkak të ndonjë inovacioni, zbaton ose jo një metodë të tillë ndërtimi e cila e lejon ta ulë çmimin. Shpjegimi në këtë rast ka kuptimin e vërtetimit të qartë me dokumente, jo vetëm me deklaratë. Rrëzimi i një operatori me arsyetimin për çmimin jo normalisht të ulët, që është përcaktuar në nenin 61 të Ligjit të prokurimit publik, nuk mund të bëhet pa verifikuar në mënyrë dokumentare, të matshme dhe qartësisht faktike disa rrethana që kanë të bëjnë me situatat në të cilat mund të gjindet tenderuesi, shembull; -ka stok për produkte të tilla dhe e vlerëson se futja e stokut në projekt/tender do të ishte forma më e mirë e përfitimit e që në rastin konkret duhen ofruar dokumentet relevante regjistrimit dhe posedimit të stokut; -ka marrëveshje preferenciale me prodhues të caktuar për shkaqe të ndryshme, shembull për shkak se bashkëpunojnë gjatë e që edhe në këtë rast si dëshmi duhen sjellën ofertat e shkruara dhe vulosura nga ofertuesit e operatorit; -ka marrëveshje për kompensim borgji apo kontratë të caktuar e që përsëri duhet të sillen kontratat relevante apo marrëveshjet e kompensimit.

Zbatimi i çmimit jo normalisht të ulët, pa verifikim faktik, është subjektiv dhe për pasojë arbitrar. Megjithatë kjo vetëm në një rast, komunës tonë i ka kushtuar buxhetit një dëm financiar prej 75,730.00€. Nuk do të zgjasë më shumë për të folur për shkeljet e tjera sepse ndoshta është folur e do të flitet edhe nga të tjerë, por do të doja që në raportin e radhës, të shohim se përgjegjësia për pozitën publike dhe për pasurinë e qytetarëve të Komunës së Podujevës, ka sadopak përparim.

Kryesuesi i Kuvendit, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, ju falënderoj për kontributin, dhe e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

6. Informatë e Drejtorisë së Administratës lidhur me punët dhe aktivitetet gjatë vitit 2020

z.Avni Fetahu, theksoi, përkundër faktit që tregon papërgjegjësinë, drejtori i DA-së sjell informatë dhe nuk qëndron këtu për ta prezantuar këtë, tregon edhe nivelin e tij, sido që të jetë për mos të lënë paqartësi tek sistemi digjital për votim që ai e ka sjell një informatë të Drejtorisë së Administratës, të dhënat që janë në Institutin GAP dhe mund t'i merrni kurdo që doni, madje edhe ato statistika se sa

kanë lindur dhe sa kanë vdekur, pra asgjë nuk ka në atë raport. Sistemi digjital për votim në sallën e Kuvendit është paraparë të zhvillohet procedura e prokurimit me datë 11.03.2020 dhe ne tani jemi në dijeni se në cilin muaj jemi dhe ende thuhet se janë në procedurë e që kjo të jeni të bindur të nderuar kolegë asamblistë se asgjë nuk tregon, vetëm tregon se nuk e kanë ende “pazargjin për ta goditë pazarin” kush me marrë tenderin, gjë tjetër nuk ka këtu.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në kuadër të strukturës organizative të një komune normalisht që është edhe Drejtoria e Administratës dhe jo rastësisht që edhe në ligje shpeshherë thuhet administrata komunale, do të thotë aq rëndësi ka administrata dhe administrimi i një komune por realisht edhe Kuvendi Komunal si organ përfaqësues, tani Informata që ka ardh dhe fatkeqësisht ky Kuvend ka mbet në atë situatë që ne asnjëherë nuk kemi raport, asnjëherë nuk kemi pasur raport të qartë nga Drejtoritë, (qoftë nga Kryetari i komunës se Podujevës i cili ka shkuar dhe mos u ktheftë më, qoftë edhe nga ky që kurrë mos u bëftë), nuk janë në gjendje të raportojnë, dhe ku nuk ka raport të punës atëherë dihet se kjo është injorancë ndaj llogaridhënies. Raporti është aq formal, raport me statistika rreth dokumenteve të lëshuara nga shërbimet përkatëse siç e potencoj edhe parafolësi sa ka lindur, sa kanë vdekur e të ngjashme, mirëpo administrata e një Komune apo ajo e nivelit qendror, duhet të shohim kreativitet aty, duhet të shohim diçka rreth stafit dhe shërbimeve që kryhen, rreth trajtimit të tyre ndonjëherë, a vlerësohet ndonjëherë e të tjera, prandaj për këtë informatë nuk di çfarë të themi, madje edhe pse nuk mund të quhet as informatë po e lemë ashtu që është informatë e atyre që më mirë dinë të informojnë padronët e vetë lidhur me shumë gjera tjera sesa që dinë të informojnë asamblenë komunale për punën e tyre.

Megjithatë me vie keq që drejtori nuk është prezent sikurse që nuk ka çfarë të mbrojë sepse kjo informatë është vërtetë shumë e ceket por realisht paraqet edhe nivelin që ka Drejtoria e Administratës, por që ka qenë mirë të jetë më e zgjeruar sepse në këtë Drejtori hyn edhe arkivi sikurse që hyjnë edhe shumë fusha tjera që mbulojnë këtë komunë, shembull përse të mos jetë brenda informatës edhe çështja e ankesave të qytetarëve që kanë bërë për emërtimin e rrugëve sepse ne nuk kemi informata zyrtare, por sa jemi në dijeni kemi afër mbi 200 ankesa të qytetarëve të cilët janë ankuar normalisht si e drejtë e tyre ligjore por edhe si e drejtë qytetare që i garanton edhe Ligji dhe Kushtetuta është dashtë t’iu përgjigjemi në afatin ligjor dhe është dashur që kjo të jetë këtu, por edhe këto kërkesa që kanë bërë qoftë edhe Drejtoritë mes vete ka qenë mirë të paraqiten, shembull cilat kanë qenë natyrat e kërkesave dhe ankesave, të gjitha këto çështje me qëllim që ne të kemi një pasqyrë të qartë se si funksionon ose edhe për fusha tjera që janë mjaftë të gjera. Unë nuk dua të shtoj diçka më shumë sepse me të vërtetë nuk ja vlen edhe të harxhoj fjalë për këtë informatë përderisa nuk marrin rolin e raporteve apo sistem raportimi që të futet në institucion sepse mendoj që informatat e tilla janë vetëm që të na qesin hi syve dhe të mundohen të arsyetohen se po bëjnë diçka.

z.Mimoza Stublla – Abdullahu, theksoi, duke u bazuar në këtë informatë lidhur me punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2020 deri në muajin tetor, lidhur me këtë ngreh shqetësimin tim për funksionalizimin e e-kioskës e cila më shumë është jashtë funksionit sesa në funksion, gjë për të cilën na është dëshmuar edhe shifrat e nxjerra të certifikatave ku në total nga janari e deri në qershor janë nxjerr vetëm 839 certifikata nga e-kioska ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë nxjerr 43 mijë e 99 copë, e që i bije që kjo e-kioska është shfrytëzuar vetëm 2% nga shifra totale e nxjerrjeve të certifikatave, andaj në bazë të kësaj kam pyetur se pse asnjëherë Komuna e Podujevës nuk ka mundur të arrijë qëllimin e synuar në këtë drejtim dhe kisha për të shtuar që përderisa kjo e-kioskë është synuar për t’iu dalë në ndihme qytetarëve dhe për t’ua lehtësuar punën kjo veçse i ka dëmtuar qytetarët, madje mërgimtarët i ka dëmtuar edhe më shumë pasi që ka pasur raste që i kanë futur parat për të nxjerrë certifikatat dhe nuk kanë mundur t’i nxjerrin nga kjo e-kioskë, kjo i ka dëmtuar në buxhet qytetarët sidomos mërgimtarët.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket informatës së Drejtorisë së Administratës, kam një pyetje direkte, në bazë të të dhënave që i kemi, janë 30 persona deri më tani në kontratë mbi vepër për detyra specifike të cilët e tejkalojnë 6 mujorin në bazë të ligjit në fuqi (Ligjit të punës dhe Ligjit për shërbyes civil) por disa prej këtyre të angazhuarve, shembull janë edhe në shëndetësi duke mos dashur me hy direkt në numër dhe në emra që është e logjikshme por edhe tek punëtorët e shëndetësisë në bazë të raportit nuk janë përdorur normat formale të rekrutimit sepse shembull të pranohet një njeri të punoj në shëndetësi dhe mos të hyjë në formë të intervistimit dhe të punoj mjek ose infermier është interesante, pastaj edhe te punëtorët teknik, këtu janë pozita të përhershme të detyrave dhe në bazë të ligjit janë pozita të përhershme të detyrave këtyre punëtorëve është dashur t'iu bëhet kontratë e rregullt sepse nuk janë punëtor që duhen sot, dhe shembull 4 -5 teknik që janë angazhuar janë pozita të përhershëm domethënë në tension janë duke mbajtur që 8 muaj 30 punëtor dhe nuk ka arsye kjo. Do të thotë nëse janë pozita të përhershme ju vazhdoni kontratat, ne nuk jemi kundër punësimeve shumë në rregull është që janë marrë në punë mirëpo ose duhet t'i shkëputni kontratat e të hapet konkurs i ri sepse nuk mund të themi se është formë e mirë e gjendjes së administratës, e që nuk po flasim vetëm a lëshohet një certifikatë që e ceku Drejtori z.Isuf Latifi që i kemi marr ekstraktet, administrata nuk është vetëm për të lëshuar certifikata të lindjes dhe të kurorëzimit ka edhe shërbime të tjera në tërësi, kështu që meqenëse Drejtori i Administratës nuk është i pranishëm dhe kjo pikë thuhet vetëm përfundon këtu dhe nuk kem çka të zgjasim më shumë. **Kryesuesi i Kuvendit**, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, i falënderoj parafolësit dhe e konstatoi të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

7. Emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë (pasi që 2 ish anëtarët nuk janë më këshilltarë të Kuvendit)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se 2 ish anëtarët e këtij komisioni nuk janë më anëtar të Kuvendit andaj edhe kërkohet të bëhet emërtimi i anëtarëve të rinj në këtë komision.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pasi që z.Bunjamin Hoti nuk është më anëtarë i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë, propozohet z.Adnan Zymeri.

z.Bajram Ajeti, theksoi, kur u përmend ndërmarrja e banesave me ra ndërmend premtimi i ngjyrosjes së këtyre ndërtesave në Podujevë e që vetëm u bënë edhe më keq se që kanë qenë.

Për këtë ndërmarrje është mirë të dihet se çka bënë si dhe çështje tjera, megjithatë ne e propozojmë znj.Lirika Maliqi për anëtare të këtij komisioni.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 19 vota për, 4 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër, miratohet emërimi i z.Adnan Zymeri dhe znj.Lirika Maliqi, anëtar/e të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike për Banim Sh.A. Podujevë.

8. Kërkesë për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar nga Drejtoria E Arsimit dhe Organizata Joqeveritare VORAE lidhur me funksionalizimin e dy shkollave për nxënësit e komunitetin jo shumice.

znj.Adelinë Stublla, në cilësinë e propozueses së kësaj pike e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, roli dhe rëndësia e qendrave si dhe mos zbatimi i marrëveshjes nga DKA-ja në marrëveshjen e bërë më 04 mars 2020, qendrat mësimore në Komunën e Podujevës datojnë qysh nga viti 2010-2011, në kuadër të Organizatave Joqeveritare Zëri i Ashkalinjëve Romëve dhe Egjiptianëve dhe këto qendra funksionojnë në kuadër të objekteve shkollore në Podujevë, rëndësia e këtyre qendrave është kur dihet se Komunitetet në Kosovë posaçërisht fëmijët ballafaqohen me shumë probleme të ndryshme duke filluar nga braktisja e shkollimit e deri tek martesat e hershme, gjendje të rëndë ekonomike sociale etj. Është e dijsme që këto qendra luajnë rol shumë të madh për mos braktisjen së shkollës, pastaj ka përfshirje në shumë aktivitete në këto qendra siç janë aktivitetet ndërkulturore, kurset e gjuhëve të huaja, fushata për ngritjen e vetëdijesimit tek prindërit për regjistrimin e fëmijëve në shkolla, kurse/trajnime për shkrim lexim bazik për gra, trajnime vetëdijesuese për ngritjen e vetëdijes tek prindërit, ndihmesa e fëmijëve me detyra të shtëpisë, ofrimi i çdo problemi të cilin ballafaqohen, dhe shumë aktivitete të ndryshme. Qendrat mësimore qysh nga paralajmërimi i pandemis covid-19 janë mbyllur por ne kemi vazhduar aktivitetet tona edhe online me të afërmit të cilët kane pasur mundësi të kycjes së mësimin online me ne pasi që dihet që një numër i konsiderueshëm i fëmijëve iu kanë munguar pajisjet teknologjike.

Me 04 mars 2020, Komuna e Podujevës e përfaqësuar nga z.Agim Blakqori drejtor i DKA-së në Podujevë, si dhe drejtori ekzekutiv i OJQ-ve Zëri i Romëve Ashkalinjëve dhe Egjiptasve përfaqësuar nga z.Isak Skenderi arrijnë Marrëveshjen për Bashkëpunim por që nuk po gjenë zbatim nga ana e DKA-së në Komunën e Podujevës duke u bazuar në Udhëzimin Administrative - neni 3 thuhet Komuna do të regjistroj qendrat mësimore në Ministrinë e Arsimit, pastaj për shpalljen e aplikimit të qendrave mësimore të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e që qendrat mësimore që duhet regjistruar nga Komuna janë; Qendra mësimore në SHFMU “Ibrahim Rugova” dhe qendra mësimore në shkollën fillore “Shaban Shala” si dhe zotime të tjerat të cilat janë në këtë marrëveshje e cila tashmë nuk po gjenë zbatim nga DKA, dhe për shkak të moszbatimit të kësaj marrëveshje janë ndërprerë mësimet dhe aktivitetet në këto dy qendra.

Sot në Komunën e Podujevës vijon mësimi i rregullt nga radhët e komunitetit jo shumicë, lagjja “Xhafer Meta” (në shkollën fillore vijon mësimin e rregullt 57 nxënës, në shkolla të mesme 4 nxënës), mandej në lagjjen “Ali Ajeti” (në shkollën fillore 54 nxënës, dhe në shkollë të mesme 5 nxënës), numri në total i fëmijëve në shkollën fillore janë 111 nxënës, numri total në shkolla të mesme është 9 nxënës, numri total i studentëve është 2, numri total i studentëve që kanë përfunduar është 2. Pra më vie keq për shprehjen tuaj që nuk duhet të kaloj kjo pikë e rendit të ditës, ju si drejtor në informatën për arsim nuk keni raportuar për këto aktivitete, për këto shkolla dhe për këta nxënës. Pra shpresoj që të filloj përkrahja e tyre jo vetëm në arsim por edhe në aspektin social dhe atë infrastrukturorë.

z.Agim Blakqori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, theksoi, arsyeja pse unë kërkoja që kjo pikë të mos kaloj në rend të ditës nuk kishte të bëjë që nuk jemi të interesuar për këtë problematikë por dëshiroj që edukimi dhe arsimimi i fëmijëve të komuniteteve jo shumicë të mos politizohet. Çështja tjetër është ajo që qendrat mësimore janë themeluar siç e cekët edhe ju znj.Adelinë Stublla ka një kohë të gjatë dhe vetë fakti që në muajin mars 2020 unë si drejtor i DKA-së kam nënshkruar marrëveshje me këtë organizatë tregon vullnetin dhe përkushtimin ton në krijimin e kushteve sa më

të mira për fëmijët e komuniteteve jo shumicë. Unë dëshiroj që këtë çështje mos ta politizojmë dhe për atë arsye desha që mos jetë pikë në rend dite, jo pse nuk është e rëndësishme.

Unë po besoj që keni pasur rastin ta shihni edhe marrëveshjen dhe aty flitet për një periudhë 3 vjeçare ku fillimisht përgjegjësia merret edhe për rekrutim të stafit por edhe çështje tjera organizative dhe gradualisht të kalojmë në zyrtarizmin e këtyre qendrave dhe në momentin kur këto qendra regjistrohen dhe zyrtarizohen në Ministrinë e Arsimit komform udhëzimit administrative atëherë përgjegjësinë e marrim në jo vetëm për sigurimin e hapësirës dhe nevojave që ka ajo qendër por edhe rekrutimin e stafit ku me Udhëzim Administrativ edhe definohet se si do të bëhet, në momentin kur ne bëjmë rekrutimin e stafit atëherë marrim obligim dhe i kryejmë obligimet sikurse edhe për stafin tjetër që kemi të rregullt në arsim. Me sinjeritetin më të plotë që ju them se kam biseduar edhe me 3 tutor që kanë marr pjesë dhe që kanë aktivitete në këto qendra por i kam thirr edhe përfaqësuesin e organizatës dhe kemi mbajtur takim të përbashkët, mënyra procedurale si tentonin ajo organizatë t'i kryej obligime ndaj këtyre tutorëve ishte jo ligjore, formë e cila në aspektin e organizatës ka hapësirë, por në aspektin e institucioneve ne nuk mundemi që dikush tjetër të bëjë rekrutimin e stafit kurse DKA të bëjë pagesën e tyre, pra kjo është çështja apo poenta dhe ndoshta edhe tutorët këtu e kanë brengën e tyre. Sa i përket asaj që u shtrua se përse nuk është duke funksionuar qendra, e them që sigurisht vetëm se nuk janë duke mundur t'iu sigurojnë pagat dhe mëditjet që i takojnë atyre organizatave në fjalë, jo Drejtoria e Arsimit sepse asnjëherë nuk kemi marrë përsipër që do ta bëjmë këtë të paktën derisa të zyrtarizohet kjo çështje. Shembulli i Komunës së Podujevës ndiqet dhe marrim përshëndetje prej të gjitha komunave, ndoshta jemi shembulli prej më të mirëve se si i trajtojmë fëmijët e komuniteteve dhe mund t'i shohim nëpër shkolla që asnjëherë nuk kemi tentuar që t'iu bëjmë trajtim tjetër por çdoherë fëmijët e komuniteteve janë pjesë e klasave me fëmijët e komuniteteve shumicë, dhe kjo është ajo pse unë në raportet e caktuara nuk i'u referohem me fëmijë të komunitetit jo shumicë sepse i trajtojmë të barabartë dhe sikurse fëmijët e komuniteteve shumicë, pra kjo është arsyeja.

Unë edhe njëherë po e them që vet fakti që jeni marr me këtë çështje uroj mos të politizohet, por unë ju kam sqaruar edhe në takim me përfaqësuesit e organizatës, hulumtoni gjeni një formë ligjore që kemi bazë ligjore unë do të jem në përkrahje për ju, ne kemi shprehë vullnetin tonë si institucion dhe si DKA dhe unë si Drejtor që të gjejmë forma dhe t'i mbështesim, fakti që kemi nënshkruar një marrëveshje të tillë kjo është çështja. Ne në të ardhmen do të aplikojmë që t'i regjistrojmë këto qendra jo vetëm këto dyja por edhe qendrat tjera dhe t'i vëmë nën ombrellën e institucionit të DKA-së dhe atëherë do ta kemi më lehtë të menaxhueshme përfshirë edhe realizimin e programeve, sepse kjo çështje është risi për sistemin e Arsimit në Republikën e Kosovës e që ne vazhdimisht kemi konsulta edhe me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit e që edhe ata kanë dilema sa i përket zbatimit të Udhëzimit në fjalë, madje një Udhëzim Administrativ paraprak është ndryshuar ende pa filluar zbatimin në tërësi për shkak se gjatë fillimit të zbatimit është vërejtur vështirësi në zbatim. Në momentin kur qendrat në fjalë të regjistrohen e që jemi në procedurë të regjistrimit, atëherë kompetencat kalojnë në DKA dhe do t'i marrim përsipër të gjitha obligimet, ndërsa sa i përket asaj që kinse nuk është duke u zbatuar marrëveshja nga Drejtoria e Arsimit, nuk qëndron, e them edhe njëherë me përgjegjësi të plotë se nuk qëndron por obligimet që i kemi marr ne do ti zbatojmë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj që vërtetë problematika është e ndjeshme dhe problematikat duhet të jenë pre okupuese për ne, kjo është vetëm një fushë e jetës së komuniteteve jo shumicë, unë kam qenë i kam vizituar se si e kanë mirëqenien, banimin dhe vërtetë ne duhet të jemi të interesuar por unë kam bindjen që premtimet që na i dha drejtori i DKA-së (nëse ka fat dhe do të jetë ende drejtor sepse tash së fundmi po flitet gjithçka) këto që i premtuat kërkoj t'i realizoni sepse është një komunitet jo shumicë me nevojë, dhe më erdhi mirë nga ana e drejtorit të DKA-së në atë fjalinë që

tha se “në raporte nuk i kam ndarë komunitetet jo shumicë si rome ashkalinjë dhe egjiptas sepse i trajtojmë të barabartë” edhe unë mendoj që është një parim shumë i drejtë që t’i trajtojmë të barabartë, por është mirë që edhe t’ua bëjmë kushtet e barabarta.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka ndokush çfarë të shtoj, atëherë shpreh falënderim për ngritjen e çështjes në fjalë dhe që të zbatohet sa më mirë kjo marrëveshje, faleminderit për angazhimin dhe zotimin që kjo marrëveshje vërtetë të realizohet ashtu siç duhet në mënyrë që të përfitojnë komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës, andaj me shpresën dhe kërkesën që marrëveshja e bashkëpunimit të zbatohet nga të dyja palët, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

9. Të Ndryshme

z.Vendenis Lahu, theksoi, në fillim të kësaj mbledhje u diskutua për çështjen e zgjedhjeve ku Nënkryetari z.Nexhmi Rudari i kuptoi dhe nënkuptoi fjalimet tona si në kuadër të fushatës mirëpo ajo që dua të them është se kam marr ankesë nga banorët e “Lagjes së Dëshmorëve” pikërisht nga familjet e Dëshmorëve në pjesën që janë vendosur më parë, rrugët e tyre janë në gjendje si mos më të keqe, ne para disa ditësh kemi parë që janë bërë disa fotografi aty, janë bërë disa punime në atë pjesë të rrugës, në hyrje aty janë vendosur banorët e fundit dhe ndoshta në kuadër të kësaj fushate Nënkryetari e sheh si mundësi ndikimi të votës më shumë tek ata, ose ndoshta është paragjykim i imi se ai mendon se në pjesën tek familjet e Dëshmorëve ka më pak gjasa të marr vota, nuk e di por ajo çka di unë është që gjendja në pjesën tjetër që nuk duket në fotografitë e publikuara është si mos më e keqe dhe kam marr ankesa të shumta rreth kësaj çështje, andaj është mirë që meqenëse ka filluar asfaltimi aty të bëhet për të gjithë Lagjen, edhe në rrugët tjera edhe në rrugët që shpiten tek familjet e Dëshmoreve.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, dëshiroj të ndalem tek çështja e shëndetësisë duke e ditur gjendjen në të cilën ndodhet vendi ynë dhe të asaj që nuk ka asgjë më të rëndësishme se shëndeti i njeriut, udhëheqësia e Komunës së Podujevës nuk është aspak serioze dhe korrekte me përgjegjësitë dhe detyrat që i takojnë karshi qytetarëve, një Komunë e cila numëron rreth 90 mijë banorë vazhdon të ketë ende një ushtrues detyre të drejtorit të QKMF-së në Podujevë, në kohë pandemie e shkarkon drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale ku edhe ashtu i dobët, por më mirë i dobët sesa pa drejtor fare, bënë punësime partiake pa kriter në këtë lëmi e çka është më e keqja ende nuk ka një pediatër në QKMF, tashmë duke u rritur numri i të infektuarve me covid-19 edhe tek fëmijët si qenie më e ndjeshme e shoqërisë ata po lihen anash edhe në qoftë se kanë vetëm një grip të zakonshëm/sezonal, e vetmja mundësi është t’i drejtohen QKUK-së në Prishtinë, shtrohen disa pyetje për këtë, ku ishte drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale deri më tani, a ishte e nevojshme të shpallen zgjedhjet e jo të shkarkojë atë drejtor, a është problemi që ai nuk ka ditur ta menaxhoi shëndetësinë, ani pse dikur thurnin lëvdata për të, apo nuk po mund t’iu sjell vota partisë politike që përfaqësonte deri më tani, edhe nëse ai drejtor do të kalonte në ndonjë parti tjetër me këtë gjendje të vështirë pandemie dhe në fund të kësaj qeverisje e cila më në fund po merr fund, nuk është dashur të ndodhte një gjë e tillë, po shihet qartë që po punohet vetëm për t’i plotësuar apetitet e disa militanteve partiak e assesi të punohet për qytetarët e Komunës së Podujevës.

znj.Mimoza Stublla – Abdullahu, theksoi, unë desha të ngrisë një shqetësim timin po ashtu edhe të qytetarëve në rrugën “Skënderbeu” dhe në rrugën e re që është ndërtuar tash së fundi (rr.”Zahir Pajaziti”), rrugë në të cilat trotuari shfrytëzohet për parking, e jo për këmbësor gjë e cila po rrezikon jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve kur dihet që në rrugën “Skënderbeu” është edhe shkolla dhe fëmijët detyrohen të ecin në asfalt dhe jo në tretuar për shkak të parkingut jo të rregullt të veturave.

Po ashtu rreth-rrotullimi në rr.”Skënderbeu” është komplet i zënë me taksistë dhe parking privat prej personave civil dhe në këtë rast edhe më shumë afër rrethit rrezikohet edhe jeta e qytetarëve në këtë aspekt për arsye se asnjë kalimtar nuk mund të ecë trotuarit por vetëm në rrugë, andaj lus të ndërmermi masa në këtë aspekt pasi që unë jetoj vetë në atë lagje dhe e shohë që kanë të njëjtin shqetësim edhe qytetarët e tjerë.

z.Patriot Rudari, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë edhe pse nuk është prezent këtu, për disa rrugë të asfaltuara që po bëhen nëpër oborre, e që një pjesë e qytetarëve më thonë mua, përse më parë na keni thënë që nuk vendoset asfalti nëpër oborre, andaj dëshiroj të di se janë shpronësuar ato rrugë që po duken të asfaltuara, po ose jo, nëse jo atëherë të vazhdohet ashtu edhe në projektet tjera.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, pasi që drejtori i Drejtorisë së Arsimit është këtu kam pyetje për të, a është duke pritur përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të këtij viti shkollor për ta sjellë një informatë në Kuvend, apo si keni planifikuar për ta sjellë një informatë të tillë të DKA-së.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:50

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/01-0065931/20

Podujevë,

30 tetor 2020

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi